



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 33/2023 (JR)
Datë 20.07.2023

Vendim nr. 5 (JR)
Datë 02.02.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- shpalli në seancë gjyqësore publike më datë 02.02.2024, ditën e premte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi Gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt

shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë, në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ylli Bashaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ylli Bashaj¹, me konstatimet se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 06.01.2021, të KDZh-së², konstaton përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj.

2.3. KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 671, datë 14.06.2023, në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.05.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ylli Bashaj, me funksion prokuror, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

² Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 13.04.2022, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj”.

dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

4. Komisioni e ka mbështetur vendimin e mësipërm në konkluzionet e arritura pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar për secilin prej tyre, si vijon.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] *Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, [...] pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vlerën 133.220,34 lekë (ose 1.274.340,3 lekë, nëse në analizën financiare do të konsiderohej si çmim i blerjes së apartamentit vlera 36.000 USD), e përqendruar në një vit të vetëm për blerjen e një pasurie të vetme, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka një karrierë më shumë se 30-vjeçare si prokuror, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlera e bilancit negativ zë një peshë krahasimisht të vogël në raport me vlerën e blerjes së pasurive objekt kontrolli, si dhe nga analiza financiare e kryer për çdo vit, subjekti rezulton me balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në një shumë totale prej 10.739.146 lekësh, për pasojë kjo vlerë negative nuk duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit.

Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël dhe mungesës së pasojave, nuk cenohet figura e prokurorit dhe as besimi i publikut te drejtësia.

Për sa më sipër, [...] subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] *subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.*

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] *subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”), në mbështetje të rekomandimit⁴ për paraqitje ankimi të nënshkruar nga tri vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim⁵ kundër vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi ose lënien në fuqi të tij.

⁴ *Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 30.06.2023, në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë:*
<https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/06/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-671-dat%C3%AB-14.6.2023.pdf>.

⁵ *Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 12.07.2023, në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë:*

6. Duke e konsideruar vendimin e Komisionit si në papajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisionerja Publike, me konsideratë edhe rekomandimin e ONM-së, ngre këto shkaqe ankimi:

6.1. *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 93,09 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

i. Në drejtim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit me provat e administruara, duke qenë se: (1) sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë të lidhur mes palëve më datë 27.12.2000, çmimi prej 28.000 USD është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale; dhe (2) të dhënat bankare dëshmojnë se edhe një vlerë prej 8.000 USD ka kaluar në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK më datë 13.02.2001, shtrohet si shkak ankimi fakti që duket se vlera e paguar për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 93,09 m² është 36.000 USD dhe jo 28.000 USD.

ii. Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetëtorin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. {***}, datë 03.11.2022, i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK me kërkesë të subjektit, nënshkruar nga administratori B. S., për të cilin duket se subjekti i rivlerësimit në procedimin penal nr. {***} ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.

iii. Duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me kuadrin ligjor të zbatueshëm, rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

iv. Në analizë të akteve të administruara në funksion të hetimit administrativ, përveç mospërputhjeve të deklarimeve mbi shumat e huave, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, mbetet i provuar edhe mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së i ecurisë së marrëdhënies së huave dhe shlyerjeve të tyre. Këto marrëdhënie interesi të krijuara mes palëve duhet të ishin deklaruar rregullisht që nga momenti i krijimit dhe deri në shuarjen e tyre, në këto deklarime.

v. Në këto rrethana: (1) deklaramet kontradiktore lidhur me shumat e marra hua; (2) mosdeklaramet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të shlyerjes së tyre; si dhe (3) mungesa e provueshmërisë me dokumentacion provues lidhur me marrjen, kthimin dhe me së paku në një rast, i mundësisë financiare të huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, janë rrethana që duket se duhet të analizohen dhe rivlerësohen nga Kolegji, në kuptim të efekteve juridike në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

vi. Në gjendjen që janë aktet në dosje, është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të

<https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/07/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-671-dat%C3%AB-14.6.2023-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Ylli-Bashaj.pdf>

analizës financiare, lidhur me vlerën reale të blerjes së pasurisë dhe burimeve të ligjshme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, kryesisht huat nga personat e tjerë të lidhur dhe mundësisë financiare të tyre për të dhënë huat e deklaruara.

vii. Në funksion të shkakut ankimor më sipër, në vlerësim të Komisioneres Publike proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision apo atij në Kolegj. Negativiteti i konstatuar në rastin konkret, lidhet me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj dhe nuk shtrihet në vite dhe, si i tillë, ka nevojë t'i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në drejtim të përcaktimit të saktë të nivelit të ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

6.2. Lidhur me shkollimin e vajzës së subjektit, znj. S. B., në Itali, për periudhën tetor 2013 - prill 2014. Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nuk është në formën e caktuar ligjore, që të konsiderohet me vlerë provuese gjatë gjykimit për efekt të procesit të rivlerësimit, për të krijuar bindjen se në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit ka kaluar vetëm bursa e shkollës dhe jo transfera të tjera.

6.3. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë do të duhet të gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit të çështjes në Kolegj, si organ rivlerësimi që Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

IV. Apeli kundërshtues i subjektit të rivlerësimit

7. Me marrjen dijani më datë 17.07.2023, për vendimin nr. 671/1, datë 13.07.2023, të Komisionit *“Për pranimin e ankimit kundër vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj”*, subjekti i rivlerësimit, më datë 20.07.2023, ka depozituar në Komision apel kundërshtues, bazuar në nenin 456 të Kodit të Procedurës Civile⁶, nëpërmjet të cilit ka kundërshtuar pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike në ankim, pasi i gjen ato të pambështetura në prova dhe ligj. Subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelit mospranimin e ankimit nr. {***} prot., datë 12.07.2023, të Komisioneres Publike dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton ankimin e Komisioneres Publike, për sa vijon.

7.1. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 93,09 m², pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të shoqërisë *“{***}”* ShPK shumën 36.000 USD është i gabuar. Nëse vlera 8.000 USD do të ishte çmim i shtuar për blerjen e apartamentit, duhet të plotësohej e të formalizohej me një akt të shkruar në formën e parashikuar nga ligji. Financimi nga Banka Italo-Shqiptare krijoi mundësinë për të siguruar

⁶ *Neni 456 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon: “Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër. Ankimi kundërshtues duhet t'u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit”.*

pjesën e mbetur prej 8.000 USD për të plotësuar vlerën e plotë të apartamentit prej 28.000 USD, për të cilin më parë ishin paguar 20.000 USD *cash* në arkën e shoqërisë.

7.2. Lëvrimi i kredisë nga banka, për financimin e blerjes së apartamentit nuk mund të bëhej pa vënë në hipotekë si garanci apartamentin në fjalë, edhe pse një gjë e tillë ishte bërë edhe për apartamentin në pronësi të vjehrrit. Pa pasur një kontratë të shitblerjes së apartamentit të përpiluar në formën dhe përmbajtjen e parashikuar nga ligji, dhe pa e regjistruar këtë pasuri në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nuk mund të përfitohej kredi bankare. Për këtë shkak, data e kontratës së shitblerjes së apartamentit është 27.12.2000, më herët se data e financimit, disbursimit të kredisë dhe transferimit të saj në favor të shoqërisë së ndërtimit më 13.02.2001.

7.3. Lidhur me mungesën e dokumentacionit për shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës në Itali, si dhe pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti nuk ka bashkëpunuar, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin në formën e duhur ligjore, subjekti i rivlerësimit parashtron se nuk ka pasur asnjë mundësi reale për të bërë të mundur administrimin e një numri llogarie të përdorur nga vajza, në rast se ajo ka çelur një të tillë për kryerjen e pagesave të nevojshme gjatë periudhës së shkurtër të studimeve të saj në Itali, pasi ka kaluar një kohë e gjatë e një veprim i tillë duhet të kryhej në një shtet të huaj, që për dokumentacionin e arkivuar ka periudha strikte ruajtjeje. Komisionerja Publike nuk ka marrë parasysh aktet origjinale të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Komision me procesverbalin nr. {***} prot., datë 10.11.2022, në lidhje me këto shpenzime, të cilat nuk kanë pasur nevojë për legalizim nga institucionet e huaja.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisionerja Publike të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda

afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Ylli Bashaj, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike të zhvilluar në prani të palëve.

d) *“Gjetje dhe mendim” nga vëzhguesi ndërkombëtar*

11. Nga vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, z. G. S., bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, më datë 08.01.2024, dy ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore publike, u paraqit në Kolegj akti “Gjetje dhe mendim”⁸. Në këtë akt, vëzhguesi ndërkombëtar, në kuadër të mjetit procedural “gjetje”, parashtron se: (i) nuk ka asnjë standard të paracaktuar të zbatimit të parimit të proporcionalitetit, zbatueshmëria e të cilit bazohet në faktet dhe veçoritë aktuale të çdo çështjeje dhe në interpretim të historikut financiar të secilit subjekt rivlerësimi dhe personave (personave të tjerë) të lidhur me të; (ii) në jurisprudencën e tij, Kolegji ka pasur qasje të ndryshme sa i përket përqindjes së shpenzimeve të jetesës në raport me të ardhurat, për periudhën para vitit 2000, në varësi të subjekteve të rivlerësimit; (iii) ekziston një standard ligjor sipas së cilit deklaratat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit kanë fuqi të kufizuara provuese. Ndërsa në drejtim të mjetit procedural “mendim”, vëzhguesi ndërkombëtar sjell në vëmendje pamundësinë për të dalë në një përfundim për zbatimin automatik të parimit të proporcionalitetit në procesin aktual të rivlerësimit. Vëzhguesi ndërkombëtar beson se duhet t’i rekomandojë Kolegjit të përfshijë nevojën për të zbatuar nivelin e duhur të provueshmërisë, lidhur me vërtetimin nr. {***}, datë 03.11.2022, të shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe t’i sugjerojë Kolegjit të njohë qëllimin e ankimit, që në këndvështrim të tij mbulon, gjithashtu, pjesë të vlerësimit të aftësive profesionale, lidhur me çështjen që përfshin z. B. S. në vitin 2016, në të cilën duket se ka pasur mangësi procedurale. Nga ana tjetër në këtë akt, vëzhguesi ndërkombëtar e cilëson çorientues kërkimin në ankim të Komisioneres Publike për *ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose lënien në fuqi të këtij vendimi*, pasi zbatimi i nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, i përcaktuar në ankim, i referohet vetëm ndryshimit të vendimit të Komisionit.
12. Në fillim të seancës së parë gjyqësore publike të datës 10.01.2024, trupi gjykues informoi palët në këtë proces, Komisioneren Publike dhe subjektin e rivlerësimit, mbi paraqitjen e aktit “Gjetje dhe mendim” dhe vuri në dispozicion të tyre kopje të njësuar të tij. Në kushtet kur ligji nr. 84/2016, në nenin 49, pika 10 e tij, “gjetjen” e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar e konsideron me cilësinë e provës që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston

⁷ Komisioneri Publik është njoftuar për vendimin e arsyetuar të Komisionit më datë 30.06.2023, sipas “Lajmërim marrje” dhe ka depozituar ankimin më datë 12.07.2023.

⁸ Akti “Gjetje dhe mendim” mban nr. {***} prot., datë 08.01.2024, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.01.2024.

ose ka ndodhur, trupi gjykues iu la kohë palëve në proces për t'u njohur me këtë akt dhe për të përgatitur qëndrimin e tyre lidhur me të, përpara se kjo provë t'i nënshtrohej debatit gjyqësor.

12.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 15.01.2024, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet parashtrimeve për aktin “Gjetje dhe mendim” të vëzhguesit ndërkombëtar konsideroi depozitimin e tij si një ndërhyrje të papranueshme dhe të paligjshme, për sa i takon momentit të depozitimit të tij në këtë fazë të gjykimit të çështjes, kur palët kishin depozituar parashtrimet e tyre me shkrim, si dhe për qëndrimin imponues në të se *faktet aktuale, provat dokumentare të disponueshme, zbatimi i drejtë i parimeve ligjore të zbatuara [...] do të çojnë sigurisht në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ylli Bashaj duhet të shkarkohet nga detyra, [...]*.

12.1.1. Gjetjet, sipas subjektit të rivlerësimit, bëjnë fjalë për fakte që nuk ekzistojnë ose nuk kanë ndodhur e që pasqyrojnë konsiderata personale të vëzhguesit ndërkombëtar, ndërsa mendimi i dhënë prej tij nuk mbështetet në fakte konkrete. Sa i përket gjetjes mbi parimin e proporcionalitetit, subjekti i rivlerësimit nuk sheh ngjashmëri të çështjes që po gjykohet me veçoritë e çështjeve të tjera të sjella në vëmendje nga vëzhguesi ndërkombëtar. Në lidhje me shpenzimet e jetesës për periudhën 1991-1999, të llogaritura në masën 30% të të ardhurave, përcaktimi i tyre në këtë masë është një fakt i pavarur nga subjekti i rivlerësimit dhe një gjetje e tillë është shtuar tej shkaqeve të ankimit. Lidhur me nivelin e provueshmërisë së deklaratave dhe deklaratave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, të cilave jurisprudenca e Kolegjit u ka dhënë vlerë të kufizuar provuese nëse nuk mbështeten në prova të tjera të administruara, subjekti i rivlerësimit e konsideron rikujtesë që bën fjalë për procesin e të provuarit e posaçërisht të çmuarjes së provave gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nuk mund të jetë njëherazi edhe gjetje. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje parimin e njohur se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji e ky parim nuk është anashkaluar e nuk mund të anashkalohej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

12.1.2. Lidhur me mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, sa i përket nivelit të provueshmërisë të vërtetimit nr. {***} prot., datë 03.11.2022, të shoqërisë “{***}” ShPK, lëshuar nga administratori B. S., i përfshirë në procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit parashtron se dukshëm në të dy përgjigjet e tij, si në vërtetimin lëshuar për subjektin e rivlerësimit, ashtu dhe në shkresën drejtuar Komisionit vlere e apartamentit është pasqyruar 28.000 USD. Subjekti i rivlerësimit shprehet se në asnjë rast nuk ka pasur marrëdhënie me z. B. S., i cili aktualisht është administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, pozicion i cili nuk mund ta ndalojë të informojë apo të dokumentojë me akte, veprimet e kryera më herët nga shoqëria. Sa i përket mendimit për vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilin është veçuar rasti i pushimit të procedimit penal ndaj z. B. S., subjekti i rivlerësimit vë në dukje se në ankimin e Komisioneres Publike nuk janë paraqitur shkaqe që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale apo kontrollin e figurës, por ato kërkohen të shtohen nga vëzhguesit ndërkombëtar në gjetjen e tij.

12.1.3. Në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, ndërhyrja me aktin “Gjetje dhe mendim” e vëzhguesit ndërkombëtar mbivendoset, por edhe zëvendëson Komisioneren Publike, si subjekt procedural i njohur nga ligji në kërkimet e bëra nga kjo e fundit. Ndërhyrja me interpretime e vëzhguesit ndërkombëtar ndaj qëndrimit të mbajtur nga Komisionerja Publike duket se është bërë me qëllim për të ndryshuar padrejtësisht objektin e kërkimit në ankim dhe në parashtrimet e datës 04.01.2024 të depozituara në Kolegjin për ndryshimin e vendimit të Komisionit ose lënien

në fuqi të tij. Subjekti i rivlerësimit parashtron se si në opinionin e paraqitur në Komision, ashtu edhe në rekomandimin për paraqitje ankimi nuk ka asnjë referencë e orientim për qëndrimin e Komisioneres Publike, për kërkimet e saj në ankim. Një qëndrim i tillë i Komisionerit Publik është mbajtur dhe në praktikën e ankimeve dhe gjykimeve të mëparshme të rekomanduara nga vëzhguesit ndërkombëtar, për këtë arsye, dhe në këtë rast qëndrimi i Komisioneres Publike, pasi është njohur edhe me rekomandimin e vëzhguesve ndërkombëtar, ka qenë absolutisht i orientuar. Subjekti i rivlerësimit në këto parashtrime shprehet se nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, për shkarkim nga detyra. Në kuptim të nenit 459 “Rënia në dekadencë e kërkimeve” të Kodit të Procedurës Civile⁹, edhe sikur kërkimet e pretenduara nga vëzhguesi ndërkombëtar të jenë të pa pasqyruara për shkak të çorientimit të Komisioneres Publike, sipas subjektit të rivlerësimit, konsiderohen sikur prej tyre është hequr dorë.

12.1.4. Në përfundim, duke vlerësuar se akti “Gjetje dhe mendime” i vëzhguesit ndërkombëtar bën fjalë për fakte e rrethana që nuk ekzistojnë apo nuk kanë ndodhur, por edhe për standarde ligjore të ndryshme, duke e konsideruar ndërhyrjen e tij në proces në një moment të papërshtatshëm procedural, si të pambështetur në ligj dhe në praktikën gjyqësore për të ndryshuar kërkimet e Komisioneres Publike në ankim, bazuar në pikën 10, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të refuzojë aktin “Gjetje dhe mendim”, datë 08.01.2024, të vëzhguesit ndërkombëtar.

12.2. Gjatë seancës gjyqësore publike të datës 15.01.2024, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 45 të ligjit nr. 84/2016 si dhe nenin 49, pikat 10 e 11 të ligjit nr. 84/2016, vendosi marrjen në cilësinë e provës të aktit “Gjetje dhe mendim” të depozituar në Kolegj, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.01.2024, nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Në këto kushte, trupi gjykues kërkoi nga Komisionerja Publike mbajtjen e një qëndrimi lidhur me të, për të evidentuar atë çfarë provon/përfaqëson gjetja lidhur me shkaqet e ankimit të depozituar në Kolegj, duke theksuar që ky qëndrim i Komisioneres Publike do të duhet të mbahet në këtë fazë të debatit gjyqësor. Në vlerësimin e trupit gjykues, mbajtja e një qëndrimi të qartë nga ana e Komisioneres Publike është i rëndësishëm në kuadër të procesit të rregullt ligjor dhe të drejtës për t’u mbrojtur që ka subjekti i rivlerësimit, si dhe për vendimmarrjen e trupit gjykues për vijimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

12.3. Në seancën gjyqësore publike të datës 19.01.2024, Komisionerja Publike paraqiti parashtrimet mbi aktin “Gjetje dhe mendim” të vëzhguesit ndërkombëtar, me qëndrimin se:

12.3.1. Për zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe lidhjen e tij me analizën financiare ka arsyetuar në ankim dhe në parashtrimet gjatë seancës gjyqësore publike të datës 10.01.2024.

12.3.2. Sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës përpara vitit 2000, si në ankim dhe në parashtrimet e datës 10.01.2024, është arsyetuar se në gjendjen që janë aktet në dosje është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare, pjesë përbërëse e së cilës janë edhe shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar, në drejtim të përcaktimit të saktë të

⁹ Neni 459 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “1. Kur kërkimet dhe pretendimet e papranuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre. 2. Në ankim nuk mund të parashtrihen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë”.

burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit e personave (të tjerë) të lidhur dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, si një praktikë e përdorur tashmë për analizimin e mundësive financiare të subjekteve gjatë jurisprudencës së Kolegjit.

12.3.3. Mbi nivelin e provueshmërisë së deklarimeve dhe deklaratave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, Komisionerja Publike në ankim ka vlerësuar se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Adresimi i kësaj pike në vlerësim të Komisioneres Publike i referohet Kolegjit, i cili shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit.

12.3.4. Lidhur me mendimin për sa i përket vlerësimit të pasurisë, vëzhguesi ndërkombëtar ka saktësuar situatën faktike konkrete, duke mbështetur përfundimin e çmimit të blerjes së apartamentit në shumën 36.000 USD, situatë e parashtruar saktë nga Komisionerja Publike në ankim. Sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Komisionerja Publike, ashtu sikurse ka parashtruar në shkaqet e ankimit, vendos në vëmendje të Kolegjit se kompetencën për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit është e detyruar që ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret. Në këto kushte, Komisionerja Publike i qëndron ankimit dhe parashtrimeve, duke theksuar se në gjendjen që janë aktet në dosje, përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, si dhe vërtetimi nr. {***} prot., datë 03.11.2022, lëshuar me kërkesë të tij nga shoqëria “{***}” ShPK nënshkruar nga z. B. S., për të cilin *duket se subjekti i rivlerësimit në procedimin penal nr. {***} ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.* Këto rrethana, ashtu si trajtuar në ankim *duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit.* Kjo pikë e aktit “Gjetje dhe mendim” e vëzhguesit ndërkombëtar, në zbatim të nenit B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, duhet konsideruar provë në këtë proces dhe vlerësuar si e tillë nga Kolegji. Komisionerja Publike vlerëson se rezultatet mbi procedimin penal nr. {***}, shërbejnë në drejtim të shkaqeve të ankimit, si çështje tjetër e nevojshme, për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në raport me vërtetimet e nënshkruara nga z. B. S., në cilësinë e administratorit të shoqërisë, në kushtet e përjashtimit të çdo rrethane favorizuese mes palëve.

- 13.** Në seancën gjyqësore publike të datës 26.01.2024, në fazën e bisedimeve përfundimtare të çështjes, Komisionerja Publike nëpërmjet konkluzioneve përfundimtare u shpreh se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe në një vlerësim tërësor të procedurave ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, Komisionerja Publike kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj. Ndërsa subjekti

i rivlerësimit në përfundim të këtyre bisedimeve i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e pasurisë

*Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 93,09 m², deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, blerë me kontratë shitje nr. {***} rep./kol., datë 27.12.2000, në vlerën 28.000 USD, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

14. Komisioni për këtë pasuri arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme në vlerën (-) 133.220 lekë për pagesën e këstit prej 20.000 USD të çmimit të apartamentit, në vitin 2000. Kjo pamjaftueshmëri, në vlerësim të Komisionit, nuk përbën shkak që deklarimi i subjektit të konsiderohet i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka kryer edhe një analizë hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 36.000 USD, për të cilën i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, në shumën (-) 1.274.340 lekë. Në këto kushte, edhe sikur vlera e apartamentit të konsiderohet 36.000 USD, mungesa e mjeteve financiare është e tillë që bazuar në praktikën e Komisionit, por edhe të Kolegjit në raste të ngjashme, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në përfundim, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, kohën e krijimit të kësaj pasurie, duke iu referuar edhe paragrafit 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), *Sevdari kundër Shqipërisë*¹⁰, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, Komisioni ka vlerësuar se kjo shumë nuk klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
15. Komisionerja Publike në drejtim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit me provat e administruara, nisur nga fakti që sipas përmbajtjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë më datë 27.12.2000, çmimi prej 28.000 USD është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale, ndërkohë që të dhënat bankare dëshmojnë se një vlerë prej 8.000 USD ka kaluar në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK në datën 13.02.2001, pra, pas hartimit të kontratës dhe deklarimit se çmimi është shlyer totalisht, ngre në ankim pretendimin se vlera e paguar për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 93,09 m², duket se është 36.000 USD dhe jo 28.000 USD. Duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit, edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me kuadrin ligjor të zbatueshëm, rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

¹⁰ Paragrafi 96 i vendimit të GjEDNj-së që i përket çështjes “Sevdari kundër Shqipërisë”: “[...] Gjykata gjykon se referuar një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave specifike të çështjes, shkarkimi i kërkueses, mbështetur kryesisht në faktin se ajo nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj i kishte paguar tatimet për një pjesë të të ardhurave të tij nga aktivitete të ligjshme gjatë dy dekadave të mëparshme, dhe në mungesë të ndonjë indicie të keqbesimit apo të shkeljeve të qëllimshme nga vetë kërkuesja, ishte joproporcional me qëllimet legjitime të procesit të rivlerësimit”.

16. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) konstaton se aktet në dosjen gjyqësore paraqesin këtë situatë faktike, lidhur me pasurinë objekt shqyrtimi dhe vlerën e përfitimit të saj:

16.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, është blerë apartamenti me sipërfaqe 93,09 m², në vlerën 28.000 USD, i shlyer tërësisht, prej të cilave 10.000 USD kursime nga të ardhurat, 10.000 USD marrë kredi në formën e borxhit nga të afërmit dhe miqtë dhe 10.000 USD marrë kredi nga Banka Italo-Shqiptare, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001. Vlera e deklaruar e apartamentit është 28.000 USD.

16.2. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003 (në vijim “deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2003”), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me sipërfaqe 93 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 28.000 USD, me burim krijimi: *13.000 USD kursime; 2.000 USD K. B. vëllai; 2.000 USD H. B. djali i xhaxhait; 1.500 USD S. V., Tiranë; 1.500 USD E. H., Vlorë; si dhe 10.000 USD Banka Italo-Shqiptare, kredi me interes me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 13.02.2001.*

16.3. Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, me përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se ka filluar të banojë në këtë apartament në muajin mars të vitit 2000, ndërkohë që kontrata e shitjes daton më 27.12.2000. Subjekti i rivlerësimit në vijim ka sqaruar se nuk ka pasur një akt ligjor për banimin në këtë apartament nga muaji mars deri në dhjetor 2000 dhe se apartamenti ishte ndërtuar me herët se apartamentet e tjerë në atë godinë, pasi ai vetë është interesuar për realizimin sa më shpejt të punimeve, pasi banonte në një ambient të papërshtatshëm, me lagështi, të marrë me qira, si dhe ishte me dy fëmijë në moshë shumë të vogël. Subjekti i rivlerësimit shprehet se i ka paguar *cash* znj. V. H., punonjëse e shoqërisë e ngarkuar njëherazi me financat e saj, shumën 20.000 USD, si paradhënie për blerjen e apartamentit, veprim financiar ky i formalizuar me mandatarkëtimin e nënshkruar prej saj dhe subjektit të rivlerësimit, por që ai nuk e disponon. Kjo pagesë, sipas subjektit të rivlerësimit, ka shërbyer edhe si garanci për t’u trajtuar si pronar i apartamentit deri në shlyerjen e plotë të çmimit të blerjes së tij, gjë që ka ndodhur më vonë, pasi ka pasur një marrëveshje verbale me administratorin e shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, të cilit i ka garantuar edhe pagesën e plotë të vlerës së apartamentit, qoftë edhe përmes aplikimit për përfitimin e një kredie bankare. Administratori i ka besuar fjalës së subjektit të rivlerësimit edhe për shkak të pozicionit të tij. Në kuadër të këtyre marrëdhënieve në muajin dhjetor 2000 është nënshkruar kontrata e shitblerjes dhe në muajin shkurt 2001 është kontraktuar marrëdhënia e financimit me Bankën Italo-Shqiptare, e cila ka mbuluar pjesën e papaguar prej 8.000 USD, transferuar nëpërmjet bankës të shoqëria ndërtuese.

16.4. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se pronësia mbi apartamentin është fituar nëpërmjet kontratës shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, nënshkruar mes shitësit, shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori, z. G.. H. dhe blerësit Ylli Bashaj, kundrejt çmimit 28.000 USD, shumë e cila referuar përmbajtjes së kontratës është likuiduar jashtë zyrës noteriale pa pretendime nga palët kontraktore. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë financuar nga Banka Italo-Shqiptare ShA (aktualisht “Intesa Sanpaolo Bank” ShA), përmes kontratës së financimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001, me kredi bankare në shumën 8.000 USD, me afat

48 muaj dhe qëllim financimi “blerje apartamenti”. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në datën 13.02.2001 dhe, po në këtë datë, është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK me përshkrimin “{***} për pagesën e kështit të fundit, për blerjen e apartamentit”.

Për të garantuar përmbushjen e detyrimit kundrejt bankës, në paragrafët 4.0 dhe 4.2 të kontratës së kredisë parashikohet se financimi objekt i kësaj kontrate sigurohet nga dorëzania hipotekare e z. L. K.¹¹ (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit), mbi apartamentin e tij ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë¹², si dhe garancia hipotekare mbi apartamentin objekt kontrate të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa në paragrafin 4.03 të kësaj kontrate, përcaktohet se *derdhja dhe tërheqja e kredisë mund të kryhet vetëm mbas krijimit, nënshkrimit dhe regjistrimit të garancive të sipërpërmendura*. Kredia e financuar rezulton të jetë shlyer plotësisht më datë 09.02.2004, brenda afatit të përcaktuar në kontratën e kredisë.

16.5. Në kuadër të hetimit administrativ, për të përcaktuar mënyrën e pagesës dhe kohën e shlyerjes së kësteve, Komisioni¹³ i drejtohet shoqërisë “{***}” ShPK, për informacion dhe material shkresor lidhur me: (i) kontratën e porosisë/sipërmarrjes dhe kontratën e shitjes së lidhur me z. Ylli Bashaj; (ii) mënyrën e pagesës dhe kohën e pagimit të kësteve së bashku me dokumentin e pagesës/arkëtimit të çmimit të paguar nga blerësi; (iii) dokumentin mbi dorëzimin e apartamentit nëse është bërë dorëzimi i tij; (iv) dokumentacionin kontabël të pasqyrit të pagesave sipas kontratës së shitjes, regjistër bankar/regjistër arkë; (v) dokumentacionin e dorëzuar pranë OShEE/FShU dhe UKT, për hapjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike dhe uji në emër të z. Ylli Bashaj; (vi) kontrata të ngjashme të shitblerjes së apartamenteve në objektin kur ndodhet apartamenti i blerë nga z. Ylli Bashaj.

16.6. Shoqëria “{***}” ShPK nëpërmjet shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 09.12.2022, informon Komisionin se blerësi Ylli Bashaj, me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme 93,09 m², kundrejt çmimit 28.000 USD. Duke qenë se nga momenti i kryerjes së pagesave nga blerësi ka kaluar një kohë e gjatë prej 22 vitesh, shoqëria në funksion dhe të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”¹⁴ nuk ka ruajtur dokumentet e asaj periudhe, ndërkohë që sipas legjislacionit tatimor, afati i ruajtjes së tyre është 5 vjet. Nëpërmjet kësaj shkrese, shoqëria vë në dispozicion: (i) kopje të kontratës së shitjes së nënshkruar më datë 27.12.2000; (ii) vërtetim hipotekor, datë 19.10.2000, për regjistrimin e objektit “8-katësh” në emër të shoqërisë ndërtuese, plan rievimi; si dhe (iii) kopje të aplikimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, më datë

¹¹ Në kontratën e financimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001, emri i tij përcaktohet L. K., ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe nga aktet e tjera në dosjen gjyqësore rezulton L. K..

¹² Është nënshkruar kontratë dorëzanie hipotekore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001, mes Bankës Italo-Shqiptare ShA dhe dorëzanësit L. K., i cili hipotekon në favor të bankës pasurinë, apartament me sipërfaqe 71 m² të ndodhur në rrugën “Y. B.”, Tiranë. Vjehtëri i subjektit të rivlerësimit, në disa dokumente figuron L. K., në disa të tjera përfshirë dokumentin e identitetit L. K..

¹³ Me shkresat nr. {***} prot., datë 04.10.2022 dhe nr. {***} prot., datë 23.11.2022, “Kërkesë për informacion”.

¹⁴ Neni 8 i ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” parashikon: “Dokumentet kontabël ruhen në selinë ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i njësisë ekonomike, për 10 vjet rresht, pas mbylljes së periudhës raportuese së cilës i përkasin, me përjashtim të atyre që me ligj ose akt tjetër nënligjor, u përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre”.

19.04.2001, për regjistrimin e pasurisë në emër të tij dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

16.7. Më herët, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori, z. B. S., kishte lëshuar vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.11.2022, të cilin subjekti i rivlerësimit e paraqiti në Komision, me përgjigjet e pyetësorit të datës 31.10.2022. Në këtë vërtetim, citohet se z. Ylli Bashaj më datë 27.12.2000 ka lidhur me këtë shoqëri një kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., për apartamentin me sipërfaqe 93,09 m² dhe ka paguar në favor të shoqërisë vlerën totale prej 28.000 USD, nga të cilat 20.000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8.000 USD është paguar me bankë.

16.8. Me qëllim verifikimin e vërtetësisë të vlerës së apartamentit, përcaktuar në kontratën e shitjes, Komisioni paraqiti kërkesë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për kontrata të ngjashme shitblerje të pasurive *apartment* në të njëjtën godinë 8-katëshe me apartamentin objekt shqyrtimi. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁵, ka vënë në dispozicion kontrata të ngjashme të shitblerjes së apartamenteve të gjendura në godinën 8-katëshe, ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, të nënshkruara në të njëjtën datë ose me diferencë disaditore me kontratën e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 27.12.2000. Një kontratë e ngjashme¹⁶ paraqitet, gjithashtu, pas kërkesës së Komisionit edhe nga subjekti i rivlerësimit. Nga të dhënat e këtyre kontratave, trupi gjykues konstaton se për apartamente me sipërfaqe sa ai objekt analize, të ndodhura në të njëjtën godinë, çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerat 1.400.000 lekë, 1.500.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, çmim ky dukshëm më i ulët se ai prej 28.000 USD i dakordësuar në kontratën e shitjes së apartamentit të subjektit të rivlerësimit.

16.9. Duke marrë shkas, nga përcaktimi në kontratën e shitjes së datës 27.12.2000 se çmimi i apartamentit prej 28.000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale pa pretendime nga palët dhe vlera 8.000 USD e financuar nga Banka Italo-Shqiptare është transferuar nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK më datë 13.02.2001, me përshkrimin “{***} për pagesën e këstit të fundit, për blerjen e apartamentit”, si edhe nga përafrimi i çmimit 36.000 USD me të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave në (vijim “EKB”), për vitin 2001¹⁷ (në mungesë të evidencave për vitet 1999-2000), sipas së cilave vlera e apartamentit në tregun e lirë të banesave për qytetin e Tiranës do të rezultonte 5.241.525 lekë (93 m² x 56.306 lekë/m²), Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në bazë të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për vlerën prej 36.000 USD të paguar në dy këste: (i) një këst prej 28.000 USD, paguar në datën e nënshkrimit të kontratës; dhe (ii) një këst në datën 13.02.2001, të transferimit të shumës 8.000 USD në llogarinë bankare të shoqërisë prej subjektit të rivlerësimit.

¹⁵ Shkresë “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 31.03.2023, me të cilën përcillen: (1) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, me blerës z. G. T., për apartamentin me sipërfaqe 119 m², në vlerën 1.800.000 lekë; (2) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, me blerës z. M. K., për apartamentin me sipërfaqe 93 m², në vlerën 1.400.000 lekë; (3) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2000, me blerës M. D., për apartamentin me sipërfaqe 93 m², në vlerën 2.000.000 lekë; (4) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2000, me blerës A. K., për “dyqanin” me sipërfaqe 63,27 m² në vlerën 1.400.000 lekë; (5) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2000, me blerës S. D., për “tarracë apartamenti” me sipërfaqe 106 m² sipërfaqe e shfrytëzueshme 134 m², pra, sipërfaqe e përgjithshme 240 m², në vlerën 2.000.000 lekë.

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit paraqet në Komision, kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, me blerës H. B., për apartamentin me sipërfaqe 77 m², në vlerën 1.500.000 lekë.

¹⁷ Sipas udhëzimit nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesa dhe të koeficientit “K”.

16.10. Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit prapësoi se apartamenti është blerë në vitin 2000 dhe jo 2001 dhe duke pasur parasysh vitin e blerjes, jo vetëm nuk ka qenë në dijeni për ekzistencën e çmimeve të referencës për blerje të një pasurie të paluajtshme, të cilat detyronin palët kontraktore të referoheshin në veprimin juridik të shitblerjes së pasurisë, por dhe që në asnjë rast çmimet e referencës së një enti kombëtar nuk janë aplikuar në tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe nuk kanë qenë detyruese për subjektet tregtare, ndërtuese apo edhe për blerësit potencialë të këtyre pasurive. Në vitin 2000 e më pas, çmimi i shitjes së apartamenteve në tregun e lirë (njësi monetare për metër katror) është përcaktuar mbështetur në raportin kërkesë-ofertë në tregun imobiliar e në përfundim vendosej me marrëveshje mes palëve në kontratë. Çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave në tregun e pasurive të paluajtshme janë përcaktuar e kanë marrë fuqi juridike detyruese, vetëm në vitet 2018 dhe 2019, me miratimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 dhe nr. 168, datë 27.03.2019¹⁸, me të cilat janë përcaktuar zonat me çmime reference të ndryshme. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje vështirësinë për financimin e individëve me kredi nga bankat e nivelit të dytë, pas ngjarjeve të vitit 1997 në Shqipëri dhe krijimit të besimit se kredimarrësi ishte plotësisht i aftë financiarisht për shlyerjen e saj. Për të arritur një marrëveshje me bankën, bisedimet kanë zgjatur, pasi për të përfutur kredinë është vendosur si kusht paraprak hipotekimi i apartamentit objekt analize e njëherazi dhe apartamenti në pronësi të vjehrrit L. K.. Sipas kërkesës së Komisionit për kontrata të ngjashme, subjekti vë në dispozicion kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, mes shitësit shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerësit H. B., me objekt apartamentin me sipërfaqe 77 m², kundrejt çmimit 1.500.000 lekë.

16.11. Në vijim të prapësimeve të tij, duke e konsideruar të gabuar arsyetimin e Komisionit për të përfshirë në analizë çmimin e apartamentit në vlerën 36.000 USD, subjekti i rivlerësimit referon çmimet e specifikuar në kontratat e ngjashme të dërguara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për blerjen e apartamenteve të ndodhura në të njëjtën godinë banimi me apartamentin e tij, sipas së cilave për të njëjtën sipërfaqe banimi, blerësit e tjerë kanë paguar 1.100.000 lekë, 1.400.000 lekë apo 2.000.000 lekë. Nga sa sipër, është lehtësisht e konstatueshme që çmimet janë shumë më të ulta se ai i përcaktuar në kontratën e shitjes së apartamentit të subjektit të rivlerësimit. Kontrata e shitjes, sipas subjektit të rivlerësimit, është përpiluar në formën e parashikuar nga ligji dhe nuk ka pasur asnjëherë ndryshime në vlerën e përcaktuar në të. Po ashtu, deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2003, e plotësuar 20 vite më parë, nuk ndryshon në të dhënat e deklaruara e që njëherazi pasqyrojnë edhe mënyrën e pagesave të kryera në dy këste, burimin e tyre, si dhe mënyrën e shlyerjes së detyrimeve. Vlera prej 28.000 USD është pasqyruar e pandryshuar prej shoqërisë së ndërtimit, si në vërtetimin lëshuar subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe në përgjigjen e dërguar Komisionit. Subjekti i rivlerësimit thekson se nuk ka pasur asnjëherë pagesë tjetër për shoqërinë ndërtuese përveç shumës 28.000 USD të përcaktuar në kontratën e shitjes. Nëse do të kishte një çmim tjetër, veprimi do të materializohej me një akt të posaçëm shtesë.

16.12. Duke mbajtur në konsideratë, elementë të tillë si: (i) për vitin 2000 nuk ka të dhëna nga

¹⁸ Vendimi nr. 132, datë 07.03.2018 i Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar, me vendimin nr. 168, datë 27.03.2019.

EKB-ja për çmimin e apartamenteve në tregun e lirë; (ii) kontratat e ngjashme, treguan se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit ishte gati dyfishi i vlerës së tyre; (iii) vlera e shitjes së apartamentit është më e lartë se kostoja e ndërtimit; (iv) subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistent në deklarin e vlerës së këtij apartamenti në të gjitha deklarinimet e tij, periodike apo atë *vetting*; (v) shoqëria ndërtuese ka konfirmuar faktin se pagesa është kryer në shumën 28.000 USD, Komisioni krijoi bindjen që çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë në vlerën 28.000 USD. Qëndrimin e tij për të konsideruar shumën e blerjes 28.000 USD (pra, 20.000 USD *cash* dhe 8.000 USD kredi bankare), Komisioni e mbështet në jurisprudencën¹⁹ e tij për raste të ngjashme, në vendime të cilat nuk janë ankimuar ose janë ankimuar, por jo për çmimin e transaksionit të kryer.

16.13. Pavarësisht sa më sipër, Komisioni kreu edhe një analizë financiare hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në vlerën 36.000 USD, rezultatet e së cilës treguan se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti në shumën (-) 1.274.340 lekë, mungesë e cila, bazuar në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit për raste të ngjashme, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në kushtet kur në përmbajtjen e ankimit, çmimi i këtij apartamenti përbën një moment të rëndësishëm të kësaj çështjeje, sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues u ndal në analizimin e akteve të administruara në dosjen gjyqësore, parashtrimeve të Komisioneres Publike dhe subjektit të rivlerësimit, për të arritur në një konkluzionin rreth besueshmërisë së çmimit të deklaruar prej subjektit në kontratën e shitjes.

16.14. Përpara Kolegjit, me parashtrimet dhe diskutimin përfundimtar, subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në hetimin administrativ e të përshkruar më lart, solli në vëmendje jurisprudencën e Komisionit të përmendur edhe në ankim, për raste të ngjashme, për të cilat nuk është bërë ankim nga Institucioni i Komisionerëve Publikë apo kur është bërë ankim madje dhe me rekomandimin e vëzhguesit ndërkombëtar, në të cilin mospërputhja e datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes me datën e disbursimit të kredisë për financimin e blerjes së pasurisë nuk është pasqyruar si shkak ankimi. Po kështu, subjekti i rivlerësimit edhe njëherë thekson se pa pasur një kontratë shitjeje të apartamentit në formën e kërkuar nga ligji dhe pa e regjistruar këtë pasuri në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk mund të përfitonte kredinë bankare, arsye kjo që ka krijuar mospërputhje mes datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes së apartamentit të banimit, kontratës së financimit dhe datës së disbursimit të kredisë.

16.15. Trupi gjykues, duke konsideruar gjithë të dhënat e përftuara nga aktet e administruara

¹⁹ (i) Vendim nr. 332/2021, i cili është rekomanduar nga ONM-ja dhe ankimuar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë dhe në të dy këto akte nuk është bërë ankim në lidhje me përfshirjen si burim të kredisë në vlerën 30.000 euro, e cila ishte disbursuar pas lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe palët deklarorin likuidimin në datën e blerjes, për shumë shih pikat 1.6.3-1.11 të këtij vendimi; (ii) vendim nr. 153/2019, i cili nuk është ankimuar. Shih trajtimin e bërë në lidhje me apartament me sipërfaqe 136 m² dhe apartament me sipërfaqe 73 m², faqja 6-14 e vendimit; (iii) vendim nr. 627/2023, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar. Shih pikën 13.24 dhe pikat 13.49-13.53 të këtij vendimi; (iv) vendim nr. 394/2021, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar, shih pikën 1.10 dhe 1.12 të këtij vendimi; (v) vendim nr. 581, datë 1.11.2022, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar. Shih faqe 5, paragraf 2 dhe faqe 6 dhe 7 të këtij vendimi.

dhe deklarimet/shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, mori në shqyrtim pretendimet e Komisioneres Publike lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes së pasurisë apartament, objekt kontrolli, nisur nga leximi dhe interpretimi i kontratës së shitjes, në funksion të përcaktimit të vlerës së saj provuese për secilin prej elementëve përbërës.

16.16. Konstatim i parë i rëndësishëm që bëhet në këtë situatë është ai që lidhet me dhënien e vlerës provuese të kësaj kontrate, vetëm për pjesën që përcakton mënyrën e pagimit të çmimit të saj dhe jo për dakordësinë për vetë çmimin e shitjes së pasurisë. Nga përmbajtja e kontratës shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2000, rezulton se palët kanë shprehur vullnetin e tyre në të, për shitjen/blerjen e pasurisë për një çmimi prej 28.000 USD, shumë e cila është likuiduar e plotë jashtë zyrës noteriale. Nisur nga fakti që për llogari të blerjes së kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka kredituar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK edhe një shumë prej 8.000 USD në datën 13.02.2001, pra, pas nënshkrimit të kontratës, të cilën e ka cilësuar si këst të fundit të çmimit, Komisionerja Publike ka ngritur pretendimin se kjo shumë e dytë përfaqëson një vlerë shtesë mbi çmimin e shitjes së objektit përtej vlerës prej 28.000 USD, e cila ishte shlyer plotësisht para nënshkrimit të kontratës.

16.17. Ndodhur në këto kushte, kur në kontratën e shitjes së pasurisë gjenden dy deklarime, të cilat duket se japin informacion kontradiktor për elementë të rëndësishëm të kontratës së shitjes, trupi gjykues çmoi se përcaktimi i vlerës provuese të secilit prej tyre do të duhej të bëhej nën dritën e parashikimeve ligjore që rregullojnë interpretimin e kontratave të përcaktuara në nenet 681 e vijues të Kodit Civil²⁰. Në rrethanat kur duket se dy përcaktime të rëndësishme të kontratës krijojnë kundërshti, trupi gjykues i vlerësoi dhe lexoi përmbajtjen e tyre në raport me të gjitha të dhënat e tjera të rezultuara nga hetimi e gjykimi i çështjes, për të krijuar bindjen rreth vërtetësisë së secilit prej kushteve të saj.

16.18. Në këtë kuptim, në kontratë rezulton se është përcaktuar çmimi i shitjes/blerjes së apartamentit në vlerën prej 28.000 USD. Të njëjtën vlerë ka përcaktuar si çmim edhe subjekti i rivlerësimit në deklarinimin fillestar të pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar konsekuent shpjegimit se kjo është vlera e blerjes së pasurisë duke shpjeguar edhe faktin se mënyra e likuidimit të çmimit ka qenë një detaj që nuk ka pasur shumë rëndësi për palët në kushtet e mirëbesimit të palës shitëse se nuk do të kishte shmangie nga pagimi i diferencës prej 8.000 USD sapo të merrej kredia që do të mundësonte pagimin e kësaj shume, për shkak të funksionit që ushtronte subjekti si prokuror. Këto shpjegime, në vlerësimin e trupit gjykues, vendosen në kontekstin e kohës, reputacionin e funksionit që ushtronte subjekti dhe mospasjen e ndonjë vëmendje të posaçme për të rakorduar në këto terma pagesën e çmimit, në kushtet e mungesës së legjislacionit që detyronte subjektet të deklaronin pasuritë dhe burimet e tyre. Në kohën e kryerjes së veprimit juridik, duket e arsyeshme që i vetmi kujdes që duhet të tregonin palët ishte marrëdhënia mes tyre dhe përcaktimi i kushteve thelbësore të kontratës, siç është çmimi i shitjes së pasurisë.

16.19. Çmimi i përcaktuar në kontratë deklarohet si i tillë edhe në përgjigjen që shoqëria “{***}” ShPK i kthen Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 09.12.2022, ashtu edhe subjektit me vërtetimin nr. {***}, datë 03.11.2022, duke treguar koherencë të plotë për sa i

²⁰ Neni 681 i Kodit Civil parashikon: “Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”.

përket çmimit të shitjes së apartamentit, i cili përcaktohet njësoj si në kontratë, në vlerën prej 28.000 USD. Nuk rezulton ndonjë akt tjetër i dalë prej hetimit administrativ që të indikojë se çmimi i shitjes/blerjes së pasurisë nuk është ai i dokumentuar në kontratë, duke përjashtuar në këtë mënyrë ndonjë inkoherencë në këtë drejtim edhe nga pala shitëse e kësaj pasurie.

16.20. Trupi gjykues vëren se evidentimi i pagesës së çmimit si 20.000 USD, paguar në kohën e lidhjes së kontratës dhe 8.000 USD paguar nëpërmjet kredisë bankare, nuk është një modalitet që ka rezultuar prej hetimit administrativ, por ai është deklaruar si i tillë që në krye të herës prej subjektit të rivlerësimit, duke u evidentuar nëpërmjet deklarimeve të tij, të cilat kanë qenë të njëjta që në deklarinimin fillestar të pasurisë. Ky element vlerësohet në drejtim të vërtetësisë dhe besueshmërisë të deklarinimit të subjektit të rivlerësimit si të kryera në mënyrë origjinare dhe jo nën ndikimin e justifikimit të ndonjë fakti që ka dalë nga hetimi administrativ apo nevojë të mëpasshme për të cilën Komisioni të kishte kërkuar shpjegime.

16.21. Gjithashtu, në drejtim të verifikimit të besueshmërisë të çmimit 28.000 USD të paguar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit, në mungesë të vlerave referuese të tregut të lirë në kohën e ndërtimit dhe shitjes së kësaj pasurie, trupi gjykues vlerësoi koston e ndërtimit të objekteve në qytetin e Tiranës, sipas vendimit nr. 362, datë 14.07.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit “K””, në vlerën 24.780 lekë/m² dhe vlerat e kontratave të shitblerjes së apartamenteve në të njëjtin godinë banimi²¹, të cilat variojnë nga 15.053 lekë/ m² në 21.505 lekë/m², ndërsa subjekti i rivlerësimit rezulton ta ketë blerë apartamentin me një çmim prej 300 USD ose konvertuar në 43.113 lekë/ m², si indicie të faktit që çmimi i përcaktuar në kontratë dukej i arsyeshëm dhe në raport të drejtë edhe me këto të dhëna.

16.22. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit objekt kontrolli, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisioneres Publike se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. {***}, datë 03.11.2022, i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK me kërkesë të subjektit, nënshkruar nga administratori i kësaj shoqërie B. S., për të cilin duket se subjekti i rivlerësimit në procedimin penal nr. {***} ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie. Vëzhguesi ndërkombëtar, gjithashtu, në aktin “Gjetje dhe mendim”, i rekomandon Kolegjit të vlerësojë si duhet nivelin e provueshmërisë së vërtetimit nr. {***}, datë 03.11.2022, të shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe i sugjeron të njohë qëllimin e ankimit, që në këndvështrim të tij lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale, për çështjen penale që përfshin z. B. S. dhe pushimin e hetimeve ndaj tij në vitin 2016, në të cilën duket se ka pasur mangësi procedurale.

16.22.1. Në funksion të shqyrtimit të këtyre çështjeve, trupi gjykues konstaton se për të verifikuar ekzistencën ose jo të ndonjë situatë konflikti interesi, Komisioni i drejtohet me kërkesë për informacion dhe dokumentacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit të datës 31.10.2022, për informacion mbi procedime penale ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, administratorit dhe/ose ortakëve të saj. Në përgjigjen përcjellë Komisionit, Prokuroria informon se nuk rezulton që subjekti i

²¹ Referuar kontratave të përmendura në poshtëshënimin nr. 15 të këtij vendimi.

rivlerësimit të ketë hetuar procedime penale ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, administratorit të kësaj shoqërie në periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, z. G. H. dhe bashkëshortes së tij, znj. N. H.. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij sqaron se ka pasur marrëdhënie drejtpërdrejtë me z. G. H., të cilin e ka njohur si administrator dhe pronar të shoqërisë dhe nuk ka pasur asnjë rast që të ketë kryer veprime procedurale në dëm apo në favor të tij apo znj. V. H. punonjëse e shoqërisë e ngarkuar njëherazi me financat e saj, ndërkohë që nuk ka njohur punonjës të tjerë të shoqërisë, për të deklaruar nëse ka ushtruar ndjekje penale ndaj tyre.

16.22.2. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit, subjekti i rivlerësimit paraqet dhe shkresën nr. {***} prot., datë 04.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në përgjigje të kërkesës së tij, referuar të cilës, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 238/1 i Kodit Penal, me të pandehur R. R. dhe B. S.. Në përfundim të hetimeve më datë 12.01.2016 është nisur kërkesë për gjykim ndaj R. R., ndërsa për B. S. është vendosur pushim i hetimeve. Ky i fundit rezulton administrator aktual i shoqërisë “{***}” ShPK.

16.22.3. Procedimi penal nr. {***} i vitit 2015, përbën një nga pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, që i është nënshtruar vlerësimit nga ana e KLP-së, sipas përcaktimeve të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të cilin Komisioni nuk ka evidentuar problematika.

16.22.4. Nga një përshkrim i ngjarjes për të cilën është regjistruar procedimi penal, rezulton se pasditen e datës 15.10.2015, rreth orës 18:10, patrulla e policisë përballë shkollës “{***}” ka parë dy persona, të cilët kishin ndryshuar tempin e lëvizjes kur janë vënë re prej tyre. Për shkak të dyshimeve të krijuara, punonjësit e policisë u kanë bërë thirrje për të ndaluar, por njëri prej tyre, i identifikuar më pas si R. R., ishte larguar me vrap dhe në afërsi të servis “{***}”, ka nxjerrë nga xhepi i veshjes dhe ka hedhur në tokë një çorape të bardhë, e cila, pasi është marrë dhe kontrolluar nga punonjësit e policisë, është parë se brenda saj kishte 14 qese farmacie me bimë të ngjashme me atë të llojit *cannabis sativa*, në një sasi prej 13.7 gram. Pas pak kohe, shtetasi R. R. është kapur në afërsi të lokalit “{***}”. Ndërsa shoqëruesi i tij, i identifikuar me emrin B. S., është kapur disa metra larg vendit të qëndrimit të tij, mbasi i është përgjigjur pozitivisht thirrjes së policisë. Madje ka qenë ai personi që ka bërë të njohur identitetin e R. R.. Referuar akteve të dosjes penale, shtetasi B. S. ishte nxënës në shkollën e mesme teknik “{***}”.

16.22.5. Në kushtet e kapjes në flagrancë, më datë 15.10.2015, është kryer kontrolli i banesës së z. B. S., në dhomën e gjumit të prindërve të tij ishte gjetur një krehër pistolette TT, në të cilin gjendej një fishek, që u sekuestruan në cilësinë e provës. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, me vendimin e datës 16.10.2015 “Për regjistrimin e procedimit penal”, ka vendosur: (1) regjistrimin e procedimit penal për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 283/1 e 278/2 të Kodit Penal; (2) procedimi të regjistrohet në emër të shtetasit R. R., si person të cilit i atribuohet vepra penale. Akti i ekspertimit kimik i kryer tregoi që materiali bimor rezultoi *cannabis sativa*, ndërsa nga aktet toksikologjike-ligjore u provua që të dy këta shtetas janë përdorues të kësaj lënde narkotike.

16.22.6. Nga analizimi i akteve të dosjes penale rezulton se më datë 17.10.2015, subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për z. B. S., duke kërkuar caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest në burg”, me afat 30 ditë, parashikuar nga nenin 238 i Kodit të Procedurës Penale. Me vendimin penal nr. {***}, datë 18.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të tij dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit.

16.22.7. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, më datë 11.01.2016, ka marrë vendimin për pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim B. S., i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 283/1 e 278/2 të Kodit Penal. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit arsyeton se [...] *arrihet në përfundimin se i pandehuri R. R., ashtu edhe personi nën hetim B. S. janë përdorues të lëndëve narkotike. Por ndërsa i pari është kapur në flagrancë, me një sasi prej 13 gram lëndë narkotike të ndarë në porcione, i dyti nuk është konkretizuar si mbajtës i kësaj lëndë. Në procesverbalet e përpiluara për të pasqyruar këtë fakt, siç janë ata të kapjes në flagrancë dhe raporti i shërbimit të përpiluar në momentin e ngjarjes prej punonjësve të policisë së patrullës tregohet qartë se mbajtës i bimës narkotike është i pandehuri R. R.. Në këto akte nuk pasqyrohet asnjë e dhënë që të tregojë se personi nën hetim B. S. është bashkëpunëtor i të pandehurit R. R. [...]. Në rastin konkret, pavarësisht dyshimeve që ngrihen për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, dyshime të cilët kalojnë në favor të personit nën hetim B. S., [...] vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, është kryer vetëm nga i pandehuri R. R. dhe jo në bashkëpunim me personin nën hetim B. S..* Ndërsa sa i përket veprës tjetër penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, z. A. S., babai i personit nën hetim B. S., i pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit²², ka sqaruar se për rreth 15 vjet ka qenë kryetar i Komunës Lis në rrethin e Matit dhe për shkak të detyrës ka qenë i pajisur zyrtarisht me armë brezi të llojit pistoletë të markës TT (“Leje mbajtje armë zjarri” nr. {***}). Bashkë me pistoletën ka marrë edhe dy krehra me fishekë luftarakë. Pas mbarimit të detyrës kishte dorëzuar armën, por nuk kishte dorëzuar njërin prej krehrave, sepse nuk e ka gjetur në banesën e tij në Burrel, ndërkohë që kishte harruar që mund ta kishte në banesën e tij në Tiranë, ku banonin vajza dhe djali i tij. Pikërisht krehri i gjetur në banesë ditën e ngjarjes së mësipërme, në të cilën është implikuar edhe djali i tij, ishte ai që i mungonte. Subjekti i rivlerësimit në vendimin e pushimit të hetimeve ka theksuar se sa më sipër, si dhe fakti tjetër se një fishek i vetëm nuk mund të justifikojë termin “municione” të përdorur në dispozitën që parashikon veprën penale në fjalë passjellin mungesën e elementëve të veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal.

16.22.8. Ndërsa lidhur me personin tjetër R. R., subjekti i rivlerësimit, më datë 12.01.2016, ka paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2015”, duke kërkuar gjykimin e çështjes penale me të pandehur R. R., i akuzuar sipas nenit 283/1 të Kodit Penal. Me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit R. R. dhe dënimin e tij me 5

²² *Procesverbal, datë 01.12.2015, “Mbi deklarinimet e personit që tregon rrethana të hetimit”.*

vite e gjashtë muaj burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, R. R. u dënua përfundimisht 3 vjet e 8 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit për një kohë prove prej 3 vjetësh, me kusht që i pandehuri të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale. Pas ankimit ndaj këtij vendimi të ushtruar nga prokurori i çështjes Ylli Bashaj, për ndryshimin e vendimit dhe dënimin vetëm me burgim të pandehurit R. R., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 03.05.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit.

16.22.9. Faktet e mësipërme të rezultuara nga dosja penale që i përket procedimit në fjalë u sollën në vëmendje nga trupi gjykues, jo në funksion të analizimit të tyre në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por të përcaktimit të vlerës provuese të vërtetimit të lëshuar prej z. B. S. në përgjigje të kërkesës së subjektit në të cilën përcaktohet, jo vetëm vlera e çmimit të shitjes së apartamentit, por edhe modalitetet e pagesës së tij. Trupi gjykues vlerësoi se opinioni i dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar në aktin “Gjetje dhe mendim”, lidhur me mundësinë e Kolegjit për të marrë në analizë këtë procedim penal në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, referuar edhe qëllimit të ankimit, së pari, nuk u mbështet nga qëndrimi që mbajti Komisionerja Publike në përgjigje të kërkesës së gjykatës, duke e fokusuar analizimin e këtij procedimi vetëm në kuadër të besueshmërisë së të dhënave që jep z. S. me cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, dhe së dyti, edhe nga leximi që trupi gjykues i bëri ankimit dhe shkaqeve të tij, në të cilin është e përcaktuar se analizimi i këtij procedimi duhej të bëhej vetëm në funksion të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe jo atij profesional, për të cilin ankuesja nuk ka ngritur ndonjë pretendim. Në këto kushte, vlerësimi i këtyre fakteve prej trupit gjykues u bë vetëm në funksion të përcaktimit të vërtetësisë së deklarimeve të dhëna në shkresën e nënshkruar prej këtij shtetasi dhe nëse këto deklarime ishin ndikuar në ndonjë mënyrë nga ndonjë favorizim që subjekti i rivlerësimit i kishte bërë z. S. në kohën e trajtimit të çështjes penale ndaj tij në vitin 2016.

16.22.10. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi mangësi, veprimtari hetimore të paplotë apo ndonjë sjellje të subjektit të rivlerësimit që do të krijonte premisa për favorizim të z. S. në procedimin penal në fjalë, që më pas do të vinte në pikëpyetje saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit në raport me vërtetimet e nënshkruar nga z. B. S., në cilësinë e administratorit të shoqërisë. Gjithashtu, nga analizimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, z. B. S., rezulton të jetë emëruar në cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie, më datë 22.06.2021 dhe në kuadër të kësaj cilësie ka nënshkruar si vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.11.2022, drejtuar subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe përgjigjen nr. {***} prot., datë 09.12.2022, drejtuar Komisionit, lidhur me kontratën e shitjes së apartamentit objekt kontrolli, të drejtë dhe detyrim që ia atribuon ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në nenin 95, pika 3 të tij. Në raport me kohën kur subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin, më datë 27.12.2000, rezulton se z. B. S. ka qenë vetëm 4 vjeç dhe deri në momentin kur administratori aktual i kësaj shoqërie B. S. është përfshirë në procedimin penal nr. {***}, më datë 15.10.2015, të pushuar nga subjekti i rivlerësimit, ka kaluar një periudhë e gjatë kohore prej 15 vitesh, si dhe nga pushimi i procedimit deri në lëshimin e vërtetimit nr. {***} prot., datë 03.11.2022, ka kaluar një periudhë tjetër e gjatë kohore 7 (shtatë) vjeçare. Në analizë të këtyre të dhënave, trupi gjykues, së pari, nuk konstaton asnjë element që do të përbënte një rrethanë favorizuese për B. S. në procedimin penal që të motivonte arsyeshëm atë të lëshonte vërtetime për subjektin e

rivlerësimin në deformim të situatës reale. Së dyti, nga leximi i përgjigjeve që z. S. ka përcjellë, si për Komisionin, ashtu edhe për subjektin, nuk rezulton ndonjë mungesë koherence apo kundërshti lidhur me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes për apartamentin përveç elementëve shtesë që jepnin informacion rreth modaliteteve të pagesës, të cilat konfirmojnë atë që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues, pavarësisht arsyetimit të mësipërm, mori në konsideratë për mbajtjen e një qëndrimi rreth çmimit të shitjes, kryesisht të dhënat e shkresës me nr. {***} prot., datë 09.12.2022, përcjellë si përgjigje Komisionit, për të cilin nuk ka ngritur pretendime as Komisionerja Publike dhe as Vëzhguesi Ndërkombëtar, si edhe pati në vëmendje edhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.11.2022, krahas tërësisë së akteve të administruara në dosjen gjyqësore, duke mos i dhënë atij një peshë të rëndësishme në vlerësimin e gjithë situatës.

16.23. Në përfundim, lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se çmimi i blerjes së këtij apartamenti duhet konsideruar në vlerën prej 36.000 USD, trupi gjykues, pasi analizoi përmbajtjen e kontratës së shitblerjes të nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, në datën 27.12.2000 dhe interpretoi të dhënat e deklaruara në të, sipas rregullave të nenit 681 e vijues të Kodit Civil, në raport me sjelljen e palëve gjatë dhe pas lidhjes së saj, si dhe në një vlerësim të harmonizuar të të gjitha rrethanave që kanë dalë nga hetimi i çështjes, arriti në përfundimin se çmimi i blerjes së kësaj pasurie duhej të konsiderohej në vlerën 28.000 USD e përcaktuar si e tillë në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme lidhur mes palëve, duke mbajtur në konsideratë, por jo vetëm, rrethana të tilla si: (i) qëndrueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me çmimin 28.000 USD dhe mënyrën e shlyerjes së kësaj vlere, krahas burimeve të mirëpërcaktuara në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*; (ii) konfirmimin për vlerën e këtij çmimi të deklaruar nga shkresa e shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, me nr. {***} prot., datë 09.12.2022, përcjellë në përgjigje të kërkesës për informacion dërguar prej Komisionit, e cila konfirmon çmimin e shitjes në vlerën 28.000 USD, sipas përcaktimit në kontratën bashkëlidhurë saj; (iii) në mungesë të vlerave referuese të tregut të lirë në kohën e ndërtimit dhe shitjes së kësaj pasurie u vlerësuan kostot e ndërtimit të objekteve në qytetin e Tiranës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 14.07.2000 dhe vlerat e përcaktuara në kontratat e shitblerjes së apartamenteve në të njëjtin objekt, si *indicie* të faktit se çmimi i përcaktuar në kontratë duhej të arsyeshëm dhe në raport të drejtë me këto të dhëna; si dhe (iv) konsiderimin e faktorit kohë të kryerjes së këtij veprimi juridik, viti 2000, në mungesë të ndonjë parashikimi ligjor që përcaktonte detyrime *eksplicite* për subjektin e rivlerësimit për deklarimin e veprimeve për zbatimin e kontratës së shitjes. Në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga hetimi nuk rezultuan të dhëna që të kundërshtonin çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes dhe se mënyra e shlyerjes së këtij çmimi mbetet pa relevancë përcaktuese, lidhur me këtë shkak ankimi. Trupi gjykues vlerësoi, gjithashtu, se vërtetimi i komunikuar subjektit të rivlerësimit prej administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, B. S., me nr. {***} prot., datë 03.11.2022, nuk ka qenë përcaktues në konkluzionin e mësipërm, nëpërmjet një analize të ndryshme nga ajo që bën dhe pasqyron gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisionerja Publike në ankim ngre pretendimet se: (i) përveç mospërputhjeve të deklarimeve mbi shumat e huave në deklaratën e vitit 2003 dhe atë *vetting*, mbetet i provuar dhe mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së, i ecurisë së marrëdhënies së huave

dhe shlyerjeve të tyre. Këto marrëdhënie interesi të krijuara mes palëve duhet të ishin deklaruar rregullisht që nga momenti i krijimit dhe deri në shuarjen e tyre, në këto deklarata; (ii) mungesa e provueshmërisë me dokumentacion provues lidhur me marrjen, kthimin dhe me së paku në një rast i mundësisë financiare të huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, janë rrethana që duket se duhet të analizohen dhe rivlerësohen nga Kolegji, në kuptim të efekteve juridike në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016; (iii) në gjendjen që janë aktet në dosje, është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare, lidhur me vlerën reale të blerjes së pasurisë dhe burimeve të ligjshme të deklaruara nga subjekti për këtë pasuri, kryesisht huat nga personat e tjerë të lidhur dhe mundësisë financiare të tyre për të dhënë huat e deklaruara.

18. Në analizë të shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, aktet në dosjen gjyqësore dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit paraqesin situatën si vijon.

18.1. Si burim krijimi për këtë apartament, në deklaratën fillestare të pasurisë 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] 13.000 USD kursime, 2.000 USD K. B. vëllai, 2.000 USD H. B. djali i xhaxhait, 1.500 USD S. V. Tiranë, 1.500 USD E. H. Vlorë, 10.000 USD Banka Italo Shqiptare, bashkë me interes me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 13.02.2001”, ndërsa në deklaratën e pasurisë vetting: “[...] 10.000 dollarë kursime nga të ardhurat, 10.000 dollarë marrë kredi në formën e borxhit²³, nga të afërmit dhe miqtë dhe 10.000 dollarë marrë kredi nga Banka Italo-Shqiptare, sipas kontratës nr. {****} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001”.

18.2. Në fillim të hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë ushtrimit të profesionit ka marrë hua, në periudhën e kontraktimit për blerjen e apartamentit, që korrespondon me fundin e vitit 1999 dhe fillimin e vitit 2000. Në pamundësi për të financuar blerjen e apartamentit me kredi bankare për shkak të vështirësive të kohës, por edhe interesave të larta, një pjesë të financimit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur ta plotësojë me hua të marra nga të afërm dhe miqtë e tij, që për shkak të marrëdhënieve të ngushta të besimit, në asnjë rast nuk është mbajtur ndonjë dokument specifik, që të materializonte këto marrëdhënie. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se 2.000 USD i janë dhënë hua nga i vëllai, z. K. B., të kursyera nga puna e tij dhe e bashkëshortes. Huaja është shlyer pjesë-pjesë dhe tërësisht në vitin 2007. Djalit të xhaxhait, z. H. B., i ka marrë 2.000 USD hua, shlyer tërësisht në fund të vitit 2004. Prej mikut dhe kolegut E. H., ka marrë një hua prej 1.500 USD, shlyer tërësisht pas vitit 2004. Burimi i huas kanë qenë të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga puna. Hua në shumën 1.500 USD, marrë mikut të tij S. V., siguruar nga puna e tij si avokat. Për aftësinë paguese për secilin nga huadhënësit, subjekti i rivlerësimit shprehet se mjaftohet edhe me të dhënat e përfituara nga sistemet elektronike që pasqyrojnë aktivitetet private, siç janë pasqyruar në regjistrat elektronikë të Qendra Kombëtare e Biznesit. Huat i janë shtuar vlerës prej 13.000 USD të kursyer ndër vite nga subjekti dhe bashkëshortja. Për blerjen e apartamentit ka shërbyer dhe kredia e marrë nga Banka Italo-Shqiptare ShA, në Tiranë, për një periudhë 4-vjeçare. Kredia është shlyer në afat nga pagat, bashkë me interesat shtesë prej rreth 2.000 USD.

²³ Në kushtet kur Kodi Civil nuk njeht termin “borxh” por “hua”, në të gjitha rastet në të cilat subjekti i rivlerësimit ka përdorur termin “borxh”, është zëvendësuar me “hua”.

18.3. Në kushtet e konstatimit të deklaratimeve të ndryshme të vlerave të burimeve që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, i pyetur nga Komisioni më datë 31.10.2022, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se deklaratën e pasurisë *vetting* e ka printuar pa e verifikuar. Në të është formuluar një koncept paraprak dhe janë pasqyruar thjesht vlerat si ndarje strukturale, për pasurinë monetare të subjektit e të të tjerëve, për marrjen hua prej tyre, si dhe huan e bankës. Ky koncept ka mbetur i paverifikueshëm përfundimisht, për t'u saktësuar, para printimit të deklaratës. Subjekti i rivlerësimit thekson se kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë e mungesës së verifikimit përfundimtar të të dhënave të deklaratës *vetting*. Një gjë e tillë, sipas tij, nuk është përsëritur në përgjigjet e pyetësorit standard, të cilat përputhen me të dhënat e pasqyruara në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, që është deklaratë e përpiluar rishtazi e njëherazi ka pasqyruar fakte të cilat kanë ndodhur në një periudhë të afërt me momentin e përpilimit të saj.

18.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka konfirmuar të dhënat në deklarin e bërë prej tij në deklaratën fillestare të pasurisë 2003, sa i përket vlerave për secilin nga burimet e krijimit të pasurisë apartament. Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, huadhënësit kanë cilësinë e personit tjetër të lidhur dhe detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Komisioni, me konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën²⁴ e tij për shtrirjen e analizës financiare të personave të tjerë të lidhur vetëm në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë objekt dhurimi apo huaje, pa e shtrirë këtë detyrim mbi të gjitha pasuritë e personave të tjerë të lidhur, ka arritur në konkluzionin se tre nga katër huadhënësit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për dhënien e huave. Në këto kushte, nga huat në vlerën 7.000 USD në total, Komisioni ka përfshirë si hua të ligjshme në analizën financiare, huat e marra nga K. B., E. H. dhe S. V., pa konsideruar huanë 2.000 USD të marrë nga H. B., pasi nuk u provua me dokumentacion provues burimi i ligjshëm i të ardhurave të tij.

18.5. Në përgjigje të pretendimit të ngritur nga Komisionerja Publike, që Kolegji duhet të analizojë dhe rivlerësojë rrethana të tilla si mungesa e provueshmërisë me dokumentacion për marrjen, kthimin dhe me së paku në një rast të mundësisë financiare të huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, trupi gjykues ka analizuar aktet e dosjes gjyqësore, në këtë drejtim.

18.6. Lidhur me provueshmërinë me dokumentacion për marrjen dhe kthimin e huave, ashtu siç ka pranuar dhe subjekti i rivlerësimit për shkak të marrëdhënieve familjare dhe miqësore me huadhënësit, marrëdhënie të ngushta besimi, në asnjë rast huaja nuk është formalizuar me një akt. Një gjë e tillë, shprehet subjekti i rivlerësimit, nuk e bënë as aktualisht e as më vonë, e kjo, jo vetëm për faktin e marrëdhënies së besimit mes tyre, por edhe pasi veprime të tilla juridike, sipas nenit 80 të Kodit Civil²⁵, marrin vlerë juridike edhe kur formalizohen verbalisht. Ndërsa sa i përket kthimit të huave, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësimin dhe shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj huadhënësve, detyrim ligjor i parashikuar në nenin 4, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të

²⁴ *Shih vendimet (JR) nr. 15/2019, datë 17.06.2019, paragrafi 110, nr. 20/2019, datë 31.07.2019, paragrafi 28 dhe nr. 2/2023, datë 02.02.2023, paragrafi 17.3, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

²⁵ *Neni 80 i Kodit Civil parashikon: “Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit [...]”.*

zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003”).

18.7. Gjatë procesit së rivlerësimit në Komision lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se secila hua ka qenë nën vlerën 300.000 lekë dhe ato nuk janë shlyer tërësisht, por pjesë-pjesë. Periudha e shlyerjes së huas ka përkuar me periudhën e transferimit të subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë e Përgjithshme në prill 2002, që solli edhe rritjen e pagës mujore të tij në rreth 137.000 lekë, më tepër se dyfishi i pagës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Pakujdesia në deklarimin e shlyerjeve të huave në deklaratat periodike vjetore ka sjellë edhe pamundësinë e përcaktimit të periudhës së saktë të shlyerjes së tyre. Mosdeklarimin e saktë, subjekti i rivlerësimit ia adreson edhe faktit që hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ishte risi dhe zbatimi i tij në praktikë, ashtu sikurse çdo ligj tjetër ka sjellë këto probleme, të cilat reflektohen në deklaratat periodike vjetore. Ky ligj, sipas subjekti, nuk është parë me syrin e kujdesshëm nga ana e tij edhe për faktin se ka qenë një ligj i ri.

18.8. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka vijuar argumentin, duke u shprehur se në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, nëse gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja evidentohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaratimit nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, subjekti deklaruës thirret për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten me shkrim. Subjekti i rivlerësimit parashtron se është thirrur nga ILDKPKI-ja madje edhe së fundmi, por nuk i është vënë në dukje një gjë e tillë, fakt që tregon se nuk është marrë në konsideratë mungesa e pasqyrit të të dhënave për shlyerjen e huave. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit solli në vëmendje jurisprudencën²⁶ e Kolegjit se pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore nuk mund të shërbejnë si indikatorë të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

18.9. Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklarata noteriale dhe jonoteriale të huadhënësve K. B., H. B., S. V. dhe E. H.²⁷, të cilët kanë konfirmuar dhënien e huave në shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003, mosmbajtjen e një akti të veçantë për formalizimin e huas për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare dhe miqësore me ta, kthimin e huave me këste deri në vitet 2004 dhe 2007, si dhe burimin e shumave të dhëna hua nga punësimi apo ushtrimi i aktivitetit privat.

18.10. Në kuadër të hetimit administrativ, për të verifikuar mundësinë financiare të huadhënësve, subjekti i rivlerësimit përveç dokumentacionit mbi regjistrimin²⁸ e aktivitetit të disa huadhënësve, paraqiti dhe dokumentacion mbi të ardhurat e tyre, konkretisht: (i) të ardhurat nga pagat e K. dhe F. B., sipas “vërtetim për bazën e vlerësuar” lëshuara nga Drejtoria

²⁶ *Shih vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

²⁷ *Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2022, e z. K. B.; deklaratë jonoteriale e datës 06.11.2022 e z. E. H. dhe bashkëshortes së tij I. B.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2022, e z. H. B.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.11.2022, e z. S. V..*

²⁸ *Ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik” H. B., për veprimtarinë “Motel”, regjistruar më 03.04.2012, me NIPT {***}; ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik” I. B. (bashkëshortja e E. H.), për veprimtarinë “Notere”, regjistruar më 31.03.2003; dokument i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për z. S. V., për ushtrimin e aktivitetit si avokat, regjistruar në gjykatë me vendimin nr. {***}, datë 03.12.1998.*

Rajonale e Sigurimeve Shoqërore për periudhën 1998-2002, në vlerën 1.404.524 lekë; (ii) për z. S. V., u paraqit dokumenti “Fletë Njohim Tatimi” i vitit 2000, për aktivitetin privat në fushën e avokatisë të personit fizik “{***}”, lëshuar nga Sektori i Biznesit të Vogël, pranë Degës së Tatim Taksave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në të cilin janë pasqyruar detyrimet paguar prej tij për dy gjashtëmujorë, 40.000 lekë për secilin, si dhe xhiron e deklaruar deri në 2 milion lekë; (iii) në kushtet kur E. H. ka qenë subjekt rivlerësimi, Komisioni referon vendimin nr. 339, datë 19.01.2021, të marrë prej tij për këtë subjekt, në të cilin analiza financiare e kryer për periudhën 01.01.1993 – 31.12.2000 ka rezultuar me mundësi kursimi të subjektit H. dhe bashkëshortes së tij në vlerën 4.002.923 lekë, e mjaftueshme për të dhënë hua në vlerën 1.500 USD, në fillim të vitit 2000; (iv) për z. H. B., subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokumentacion provues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit e, për pasojë, huaja e dhënë prej tij nuk u përfshi në mesin e të ardhurave të ligjshme në analizën financiare të kryer për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit në vitin 2000.

18.11. Trupi gjykues nuk i ka konsideruar shumat e dhëna hua prej 1.500 USD dhe 2.000 USD nga huadhënësit, në atë nivel sa të kërkojnë kryerjen e një analize të mirëfilltë financiare me përfshirjen e të gjithë të ardhurave, shpenzimeve mbi numrin e anëtarëve të familjes apo pasurive të krijuara prej tyre, sipas rekomandimit për paraqitje ankimi të vëzhguesve ndërkombëtarë. Me konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën²⁹ e tij, për shtrirjen e analizës financiare të personave të tjerë të lidhur vetëm në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme huan, pa e shtrirë këtë detyrim mbi të gjitha pasuritë e personave të tjerë të lidhur, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit. Në ndryshim nga Komisioni, të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve K. dhe F. B. u përlllogaritën *neto* dhe përsëri analiza financiare tregoi mjaftueshmëri të burimeve të tyre të ligjshme financiare për dhënien e huas 2.000 USD, në vitin 2000. Sa i përket mundësisë financiare të huadhënësit S. V., me konsideratë parashikimet e nenit 3 të ligjit nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, subjekte të tatimit me kuotë fikse janë subjektet që realizojnë qarkullim vjetor deri në 2.000.000 lekë dhe detyrimet tatimore të paguara për ushtrimin e aktivitetit të avokatit në qytetin e Tiranës në vitin 2000 kanë qenë të përcaktuar me kuotë fikse 80.000 lekë në vit. Me konsideratë xhiron e deklaruar nga personi fizik “{***}” për vitin 2000 deri në 2 milion lekë dhe detyrimet e paguara në vlerën 80.000 lekë në vit, u përlllogarit fitimi vjetor *neto*, i cili rezultoi i mjaftueshëm për të dhënë hua shumën 1.500 USD subjektit të rivlerësimit, në vitin 2000. Lidhur me huan e dhënë subjektit nga z. E. H., trupi gjykues referon analizën e mundësisë për kursim të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimi E. H. dhe personin e lidhur me të, për periudhën 01.01.1993 – dhjetor 2000 të pasqyruar në vendimin nr. 339, datë 19.01.2021, e cila ka rezultuar me balancë pozitive në vlerën 4.002.923 lekë, që provon kështu edhe mundësinë e tyre për dhënien e huas 1.500 USD, në vitin 2000. Vendimi nr. 339, datë 19.01.2021, i Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit E. H. ka qenë objekt shqyrtimi nga Kolegji³⁰, por jo sa i takon mundësisë financiare për periudhën e sipërcituar.

²⁹ Shih vendimin (JR) nr. 15/2019, datë 17.06.2019, paragrafi 110; vendimin nr. 20/2019, datë 31.07.2019, paragrafi 28 dhe vendimin nr. 2/2023, datë 02.02.2023, paragrafi 17.3, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³⁰ Shih vendimin (JR) nr. 27, datë 05.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit E. H..

18.12. Për huadhënësin H. B., dokumentacioni i administruar nga Komisioni³¹ dhe ai depozituar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të hetimit administrativ nuk provuan mundësinë e tij për të justifikuar me burime të ligjshme financiare dhënien e huas në vlerën 2.000 USD, në vitin 2000. Ashtu siç ka pranuar dhe vetë subjekti i rivlerësimit, huadhënësi ka ushtruar aktivitet privat në fushën e hotelerisë, për një kohë të gjatë, në informalitet, pa u regjistruar në institucionet shtetërore. Referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.03.2023, për periudhën 1992 – 2000, huadhënësi nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat, ndërkohë që sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar, Personi Fizik “{***}”, me NIPT {***}, me fushë veprimtarie “Motel”, rezultoi i formalizuar më datë 03.04.2012. Përpos të ardhurave nga tregu informal, subjekti i rivlerësimit pretendoi se huadhënësi H. B. ka pasur mundësi kursimi dhe ka qenë klient i Bankës së Kursimeve, duke depozituar vërtetimin nr. {***} prot., datë 11.05.2023, lëshuar nga “Raiffeisen Bank” ShA. Në vlerësim të trupit gjykues, *së pari*, nuk provohet që shuma e dhënë hua është tërhequr nga banka për këtë qëllim dhe *së dyti*, në fund të vitit 1998, gjendja e depozitës nuk ka qenë 80.000 lekë sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, i cili gabimisht mbledh gjendjet e depozitës në fund të viteve 1996, 1997 dhe 1998, por 35.997 lekë. Në këto kushte, sikurse edhe në Komision, shuma e huas dhënë nga H. B. nuk është konsideruar nga trupi gjykues si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit.

18.13. Përtej verifikimit/kontrollit të mundësisë për krijimin me burime të ligjshme të shumave të dhëna hua, proces nga i cili trupi gjykues arriti në të njëjtin përfundim si Komisioni, mori në shqyrtim edhe pretendimin për mosprovueshmërinë e këtyre marrëdhënieve, sipas ankimit të Komisioneres Publike. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto marrëdhënie huaje në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, si burim për krijimin e pasurisë në fjalë. Të njëjtin deklaram ai ka kryer edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke identifikuar saktë individët që ishin në cilësinë e huadhënësve. Në këto kushte, pavarësisht pasaktësive në vlerat monetare të huazuara, të cilat janë saktësuar gjatë hetimit dhe i korrespondojnë atyre të deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë shteruese marrëdhëniet e huas që kanë shërbyer për financimin e apartamentit, ndonëse ato marrëdhënie kanë lindur para se të miratohej ligji nr. 9049, datë 10.04.2003. Jo vetëm Kodi Civil, por edhe ligji nr. 84/2016 nuk parashikon që këto marrëdhënie të jenë formale me pasojë paprovueshmërinë apo pavlefshmërinë e tyre në mungesë të një forme të caktuar. Përveç kësaj, neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon si një parakusht për lindjen e detyrimit për provimin e burimeve të ligjshme prej personit tjetër të lidhur, konfirmimin prej tij të një marrëdhënie huaje apo dhurimi, konfirmim i cili nuk do të ishte i nevojshëm nëse ajo do të duhej të ishte në çdo rast e lidhur sipas një forme posaçërisht të përcaktuar. Në këtë kuptim, deklarimi i subjektit me emrin e çdo huadhënësi, që në vitin 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, konfirmimi prej huadhënësve të këtyre marrëdhënieve, si edhe vlerat e vogla të huave me secilin prej tyre, në marrëdhënie të posaçme, të cilat konfirmohet në proces, dy prej tyre janë familjarë dhe dy të tjerë kolegë, fakte të njohura botërisht, për shkak të profesioneve të tyre, si edhe ekzistenca e këtyre marrëdhënieve deri në

³¹ *Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, vë në dispozicion vërtetim “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” i z. H. G. B., ku jepen të dhëna mbi punën e ushtruar prej tij në vitet 1975 -1989, por jo mbi të ardhurat nga pagat.*

vitin 2003, rrethanë që përkon me deklaratimet e subjektit se këto detyrime kanë filluar të shlyhen rreth viteve 2004 deri 2007, përfaqësojnë mjaftueshëm elementë që krijojnë besimin për ekzistencën e këtyre marrëdhënieve.

18.14. Në përfundim, lidhur me huat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasurinë apartament me sipërfaqe 93,09 m², pavarësisht pasaktësisë së konstatuar në vlerat e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* kundrejt deklaratimeve në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe qëndrimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues, me konsideratë faktin që këto hua janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklarin e parë të vitit 2003, vlerat e vogla të tyre, mosparashikimin nga legjislacioni civil i detyrimit për hartimin e një kontrate të caktuar për formalizimin e marrëdhënies së huas, si dhe provueshmërinë e burimeve të ligjshme për tre prej tyre, i konsideroi huat të ligjshme sikurse dhe Komisioni në vendimin e tij.

19. Në kuadër të kontrollit të analizës financiare të Komisionit, lidhur me zërin shpenzime jetese, në “Gjetje dhe mendim” të administruar në cilësinë e provës nga trupi gjykues, vëzhguesi ndërkombëtar është shprehur se Kolegji ka pasur qasje të ndryshme në varësi të veçantive të subjekteve të rivlerësimit sa i përket përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në raport me të ardhurat, për periudhën para vitit 2000, duke sjellë në vëmendje dy çështje të gjykuara në Kolegj³² në të cilat shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur 30% të të ardhurave nga pagat dhe dy çështje të tjera³³ në të cilat shpenzimet jetike janë përlllogaritur në masën 40 % të tyre. Komisionerja Publike, lidhur me këtë konstatim të vëzhguesit ndërkombëtar, ka arsyetuar se në gjendjen që janë aktet në dosje është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare, pjesë përbërëse e së cilës janë edhe shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar. Trupi gjykues çmoi t’i konsiderojë shpenzimet e jetesës, sipas qëndrimit orientues të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 15, datë 18.06.2021, në masën 30 % të të ardhurave të familjes së subjektit të rivlerësimit për periudhën përpara vitit 2000. Ky qëndrim mbështetet dhe në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlera më të larta për këto shpenzime dhe as nuk verifikohet ndonjë situatë që sugjeron për të kundërtën.
20. Komisionerja Publike ka pretenduar se negativiteti i konstatuar në rastin konkret, lidhet me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj, nuk shtrihet në vite dhe, si i tillë, ka nevojë t’i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues së Kolegjit, në drejtim të përcaktimit të saktë të nivelit të ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Duke konsideruar konkluzionet e mësipërme, vlerën e apartamentit 28.000 USD të paguar më datë 27.12.2000 shumë 20.000 USD dhe më 13.02.2001 shumë 8.000 USD përfituar nëpërmjet financimit bankar, konsiderimin e ligjshëm të tre huave në vitin 2000, prej 5.000 USD në total, si dhe përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30 % të të ardhurave nga paga, trupi gjykues, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit, konstatoi pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 93,09 m², në vlerën prej 213.115 lekësh. Ndryshimi mes diferencës negative të rezultuar nga kontrolli i analizës financiare në Kolegj me atë të konstatuar nga Komisioni në vlerën (-) 133.220 lekë është pasojë e përlllogaritjes së të ardhurave *neto* nga pagat e subjektit të

³² Shih vendimin (JR) nr. 12/2021, paragrafi 25.13, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. M. dhe vendimin (JR) nr. 5/2022, paragrafi 13.3.1, që i përket subjektit të rivlerësimit Dh. H..

³³ Shih vendimin (JR) nr. 15/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit K. S. dhe vendimin (JR) nr. 31/2021, paragrafi 23.12, që i përket subjektit të rivlerësimit G. B..

rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si dhe të efekteve të kursit të këmbimit valutor³⁴. Diferenca negative prej 213.115 lekësh konsiderohet se është në një nivel jo domethënës për kualifikimin e situatës faktike, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për shkak të vlerës së konkluduar mbi mungesën e burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se gjendet në të njëjtën linjë me standardin e fiksuar në aktin “Gjetje dhe mendim” të vëzhguesit ndërkombëtar, për sa i përket zbatimit të parimit të proporcionalitetit, i cili përjashton në këtë rast zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me shkollimin e vajzës së subjektit, zj. S. B., në Itali, për periudhën tetor 2013 - prill 2014

21. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke konsideruar faktin se shkollimi i vajzës së tij në shtetin italian ka zgjatur vetëm 1 (një) semestër shkollor dhe shpenzimet e kryera për këtë shkollim janë deklaruar saktësisht nga subjekti i rivlerësimit, si dhe janë provuar me dokumentacion provues, i vlerëson bindëse shpjegimet e tij në lidhje me këtë konstatim. Komisioni verifikoi edhe nxjerrjet e llogarisë bankare të vajzës së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 2021-2022 dhe konkludon se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me lëvizjet bankare të vajzës së tij.
22. Komisionerja Publike ka ngritur pretendimin se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nuk është në formën e duhur ligjore, që të konsiderohet me vlerë provuese gjatë gjykimit për efekt të procesit të rivlerësimit, për të krijuar bindjen se në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit ka kaluar vetëm bursa e shkollës dhe jo shuma të tjera nëpërmjet transfertave monetare. Ndërsa në diskutimet përfundimtare në Kolegj, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte apo prova të reja që të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit mbi faktin nëse në llogarinë e vajzës nuk kanë kaluar shuma të tjera, përtej bursës së shkollës apo të provonte pamundësinë objektive për të siguruar një dokumentacion të tillë.
23. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, në përgjigje të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues konstaton se:
 - 23.1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme/të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja deklarojnë shpenzime për studimet e vajzës në Fakultetin e {***} në Universitetin e Padovës, Itali, në vlerën 1.400.000 lekë. Ndërsa bashkëshortja në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” të kësaj deklarate, deklaron: “*Pakësim i pasurisë në vlerë leku 1.400.000 lekë nga Raiffeisen Bank dhe Credins Bank, nga kursimet nga të ardhurat nga paga*”.
 - 23.2. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë përdorur për të paguar shpenzimet për shkollimin e vajzës së tyre në Itali për periudhën tetor 2013-prill 2014 në shumën 1.400.000 lekë, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e përcjellë Komisionit nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.09.2020 dhe konstatoi: (a) tërheqjen e shumës 600.000 lekë investuar në T-Bills, nga V. B. me mandat tërheqje, datë 07.05.2013, prej llogarisë së saj në “Raiffeisen Bank” ShA, të

³⁴ Në Kolegj është konsideruar mesatarja e kurseve të këmbimit të datave 26 dhe 28 dhjetor 2000 (1 USD = 142.12 ALL), në kushtet kur mungojnë të dhënat në arkivën e kurseve të këmbimit valutor të ekstraktuar nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë³⁴ për datën 27.12.2000 (blerja e apartamentit).

vërtetuar me shkresë të kësaj banke nr. {***} prot., datë 06.10.2020; (b) tërheqjen e shumës 300.000 lekë nga V. B., me mandatpagesë të datës 22.10.2013, prej llogarisë së saj në “Credins Bank” ShA; (c) tërheqjen e shumës 403.821.86 lekë nga V. B., me mandatpagesë të datës 12.04.2013 dhe mbylljen e depozitës në emër të saj në “Credins Bank” ShA. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” ShA, trupit gjykues nuk i rezultojnë transfertat në favor të vajzës për periudhën tetor 2013 – prill 2014, por konstaton se subjekti i rivlerësimit e tërheq çdo muaj në *cash* pagën e tij. Ndërsa nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përcjellë në Komision nga “Credins Bank” ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2020, trupi gjykues konstaton se në muajin tetor 2013³⁵ janë kryer disa “*tërheqje në ATM jashtë vendit*”, në Padova, Itali.

23.3. Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në muajin tetor të vitit 2013 vajza e tij ka filluar studimet në Fakultetin e {***}, në Universitetin e Padovas, Itali dhe është kthyer në muajin prill të vitit 2014 në Shqipëri, për të vazhduar studimet e mëtejshme me pagesë në Universitetin “{***}”, në Tiranë. Për të provuar regjistrimin si studente pranë Universitetit të Padovas, Itali, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin³⁶ përkatës për pajisjen me leje qëndrimi, pagesën e studimit, vërtetimin mbi regjistrimin në programin e studimit “{***}” për vitin akademik 2013-2014, si dhe deklarim rezidence. Një pjesë nga shuma 1.400.000 lekë, sipas subjektit, është konvertuar në 5.750 euro, përdorur si garanci bankare, kusht për t’u pajisur me vizën për studimet në Padova, për vitin akademik 2013-2014. Nga depozita e çelur në emër të vajzës në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, në Tiranë, në shumën 5.750 euro³⁷ janë kryer veprimet e mëposhtme: (i) tërheqje e shumës 1.762 euro nga S. B. me mandat tërheqje/debitimi, datë 27.11.2013, prej llogarisë së saj në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, vërtetuar me shkresë të kësaj banke nr. {***} prot., datë 29.09.2020; dhe (ii) në datën 08.01.2014 është tërhequr prej saj shuma 3.999 euro. Periudha e këtyre tërheqjeve përkon me qëndrimin e vajzës në Itali. Subjekti i rivlerësimit sqaron se si pagesë vjetore studimi ka paguar shumën 800 euro, por disponon vetëm një mandatpagesë prej 563,38 euro të datës 02.10.2013, të bankës “Cassa di Risparmio del Veneto” s.p.a, për pagesën në favor të Universitetit të Padovës.

23.4. Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vajza, për periudhën tetor 2013 - prill 2014 të qëndrimit në Padova, ka përdorur një apartament me qira 340 euro në muaj, ka paguar tarifë fikse mujore 80 euro për shpenzime energjie elektrike, gaz gatimi dhe taksat e mbetjeve, si dhe rreth 250 euro në muaj shpenzime për ushqim. Për shpenzimet e qirasë, subjekti i rivlerësimit disponon kontratën e qirasë të përpiluar më datë 01.10.2013 nënshkruar nga palët, qiradhënës P. L. dhe qiramarrës S. B., si dhe pesë mandatpagesat (*bonifico*), që tregojnë shumat mujore prej 420 euro të paguara, sipas kushteve të kontratës (340 euro qira mujore dhe 80 euro shpenzime të tjera). Pagesat janë kryer sipas kushteve të kontratës, konkretisht në muajin e parë që përkon me datën 10.10.2013 është paguar

³⁵ Më datë 07.10.2013, shuma 36.042 lekë, më datë 09.10.2013, shuma 43.085 lekë, më datë 14.10.2013, shuma 35.907 lekë, më datë 17.10.2013, shuma 42.883 lekë dhe më datë 22.10.2013, shuma 17.100 lekë.

³⁶ Deklaratën konsullore të Ambasadës Italiane në Shqipëri; kërkesa për matricullim drejtuar Rektorit të Universitetit të Padovas; dokument për deklarim rezidence; vërtetim i skanuar nga faqja zyrtare e Universitetit të Padovas, nga zyra dedikuar shërbimeve ndaj studentëve, datë 07.10.2013, për regjistrimin e znj. S. B. në programin e studimit “{***}” për vitin akademik 2013-2014; pagesë bankare, datë 02.10.2013, nga S. B. në favor të Universitetit të Padovës, në vlerën 563.38 euro.

³⁷ Referuar lëvizjes së llogarisë bankare së vajzës S. B., burim i krijimit të shumës 5.750 euro të depozituar në *cash*, është deklaruar “*kursime të babait*”.

shuma 1.100 euro, ku është përfshirë likuidimi i qirasë mujore dhe paradhënie qiraje për dy muaj të tjerë dhe 420 euro për muajt në vijim. Për këto shpenzime, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin përkatës³⁸. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar, gjithashtu, dokumentacion³⁹ për studimet e specializimit afatgjatë të vajzës së tij pranë Universitetit “{***}” të Romës, për periudhën 2020 e në vazhdim.

23.5. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse vajza kishte çelur llogari bankare në Itali dhe i ka kërkuar vënien në dispozicion të nxjerrjes së llogarisë bankare të saj në Itali, si dhe dokumentacion provues bankar të pagesave të kryera për studimet dhe qiratë. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk është në gjendje të japë përgjigje nëse vajza ka çelur llogari bankare në Padova, Itali, por pagesat për të gjitha shpenzimet e kryera gjatë periudhës së qëndrimit në Itali, për studime e për jetesë, i janë dhënë posaçërisht nga subjekti i rivlerësimit në formën e likuiditeteve *cash*. Subjekti sqaron se edhe nëse vajza ka çelur llogari bankare, kjo gjë është bërë vetëm që ajo të përdorë ndërmjetësimin e bankës, për të kryer pagesat e nevojshme në institucionet përkatëse. Për të përmbushur detyrimet që lidheshin me studimet e vajzës është tërhequr nga llogaria bankare e bashkëshortes shuma 1.400.000 lekë. Komisioni, pasi i sjell në vëmendje faktin se në përgjigjet e dhëna nuk jepen shpjegimet e kërkuara mbi çeljen e llogarisë bankare në Itali nga vajza, si dhe vënien në dispozicion të nxjerrjes së lëvizjeve të kësaj llogarie, i kujton subjektit të rivlerësimit se mosparaqitja e këtij dokumentacioni do të konsiderohet mungesë bashkëpunimi, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

23.6. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar që vajza e tij ka një numër llogarie bankare në një nga bankat e shtetit italian, për ta përdorur për depozitim dhe pagesës periodike mujore, pasi është në periudhë specializimi në {***}”, Romë. Ai deklaron se llogari tjetër bankare vajza e tij nuk ka në këtë shtet. Komisioni, në vijim në rezultatet e hetimit administrativ, konstaton se pavarësisht kërkesave të përsëritura për vënien në dispozicion të nxjerrjes së llogarisë bankare të vajzës, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që pasqyron lëvizjet dhe transaksionet në këtë llogari, duke e vendosur Komisionin në pamundësi për verifikimin dhe analizimin e llogarive bankare të personit të lidhur S. B., si dhe në pamundësi për të bërë një analizë të plotë financiare të periudhës së rivlerësimit, duke reflektuar mungesë bashkëpunimi sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

23.7. Në kuadër të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ka përgjigje tjetër të ndryshme nga sa ka shpjeguar më parë. Vajza, sipas tij, ndoshta ka çelur llogari bankare në Padova, Itali, për të mbajtur likuiditetet *cash* që merrte nga subjekti, si i vetmi burim i financimit i studimeve të saj. Të gjitha shpenzimet e vajzës, shpenzime studimi dhe jetese, i janë dhënë posaçërisht në *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Nëse

³⁸ Kontratë qiraje për përdorim banese (*Contratto di locazione ad uso abitativo*), datë 01.10.2013, nënshkruar mes qiradhënësit L. P. dhe qiramarrëses S. B., me objekt dhënie me qira të njësisë së banimit, për një afat 4-vjeçar; pagesa bankare nga “Cassa di Risparmio del Veneto”, më datë 10.10.2013, shuma 1.100 euro (680 euro paradhënie, 340 euro qira mujore, 80 euro tarifa për mirëmbajtje) dhe më datat 10.11.2013, 12.12.2013, 14.01.2014 dhe 12.02.2014 shumat 420,50 euro (qira mujore 340 plus tarifa fikse 80 euro); dokument i datës 30.04.2014, “Kithimi i çelësave dhe rikthimi i paradhënies, për përfundimin e parakohshëm të kontratës së qirasë për përdorim banese, rruga “{***}” nr. {***}, Padova”.

³⁹ Kontratë për formimin e specializimit për vitin akademik 2020 – 2021, pranë Universitetit “{***}” të Romës; kontratë qiraje përdorim banese me natyrë transitore, në Romë, mes qiradhënësit L. E. V. dhe qiramarrëseve S. B. dhe E. T., për periudhën 01.08.2022 - 31.07.2023.

vajza ka hapur llogari bankare, kjo gjë është bërë vetëm me qëllim që ajo të depozitohet paratë e marra nga subjekti i rivlerësimit, që do t'i shërbenin për shpenzime, pagesa e të cilave mund të bëhej vetëm me ndërmjetësimin e bankës, pasi nuk mund të kryheshin veprime në *cash*. Edhe në rast se ka pasur transaksione, ato e kanë burimin e vetëm te veprimet bankare të subjektit të rivlerësimit, lehtësisht të kontrollueshme, sepse janë kryer në bankat e vendit tonë. Subjekti i rivlerësimit thekson se nuk ka pasur e nuk ka mundësi të marrë informacion për numrin e llogarisë bankare të vajzës, pasi nuk i është ofruar asgjë nga subjektet bankare jashtë shtetit, ndërkohë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ depoziton nxjerrjen e llogarisë bankare të vajzës S. B. në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, në Itali, për vitet 2021 - 2022.

23.8. Trupi gjykues konstaton se vëzhguesit ndërkombëtar në rekomandimin për ankim referojnë lëvizjet e llogarisë bankare të “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, Itali, duke pretenduar se ato nuk janë në formën e parashikuar nga ligji për t’u pranuar dhe konsideruar si provë e besueshme në këtë proces (të palegalizuara p.sh., me vulë apostile), prandaj, përmbajtja e lëvizjeve të llogarive bankare në fjalë (nga të cilat mund të konstatohet se bursa e studimit është paguar në llogarinë e vajzës së subjektit pa asnjë provë tjetër për ndonjë transferim nga dikush tjetër) nuk mund të merret parasysh nga Komisioni. Komisionerja Publike, bazuar në këtë rekomandim, gjithashtu, ngre pretendimin se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nuk është në formën e caktuar ligjore, që të konsiderohet me vlerë provuese gjatë gjykimit për efekt të procesit të rivlerësimit, për të krijuar bindjen se në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit ka kaluar vetëm bursa e shkollës dhe jo transferta të tjera. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton paqartësi në kërkimet e Komisioneres Publike, pasi lëvizjet e llogarisë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, Itali, i përkasin periudhës 2021-2022, gjatë të cilës vajza është duke kryer specializimin “{***}”, pranë Universitetit “{***}” të Romës, që nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit dhe për të cilën Komisioni nuk ka kryer ndonjë analizë financiare. Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë shkak ankimor edhe për faktin se “Konventa për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961)”, në të cilën Shqipëria aderon⁴⁰, nuk parashikon detyrimin për legalizim të dokumenteve të lëshuara nga subjekte private, përfshirë edhe lëvizjet e llogarive bankare, të cilat nuk konsiderohen dokumente zyrtare apo akte shtetërore në kuptim të saj. Në këto kushte, por dhe duke pasur parasysh faktin se lëvizjet e llogarive bankare gjenerohen elektronikisht pa qenë nevoja e paraqitjes në ambientet e bankës apo pajisjes me firmë të autoritetit bankar, vlera e tyre provuese nuk mund të komprometohet vetëm për shkak të mungesës së legalizimit. Analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të vajzës në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, Itali, për periudhën 2021 – 2022, nuk ka treguar kreditime, përveç pagesave mujore nga Universiteti “{***}” i Romës dhe dy kreditime në shumat 132 euro dhe 200 euro, respektivisht nga bashkëqiramarrësja E. T. dhe daja i saj L. K. për festat e fundvitit.

23.9. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, përveç shpjegimeve të dhëna në Komision, thekson se nuk ka pasur dhe nuk ka mundësi të marrë informacion për numrin e llogarisë së vajzës, pasi nuk i është ofruar nga subjektet bankare jashtë vendit, kur bëhet fjalë për një fakt të ndodhur rreth 10 vite më parë e kur për dokumentacionin e arkivuar kanë periudha strikte ruajtjeje. Në mandatpagesat e dorëzuara në Komision pasqyrohet një numër llogarie në emër të vajzës nëpërmjet të cilit janë kryer transaksionet bankare për pagesat e

⁴⁰ Me ligjin nr. 9060, datë 08.05.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja””.

ndryshme të shkollimit, qirasë apo jetesës. Gjithashtu, në kushtet kur disa dokumente janë autentikë, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ka pasur arsye që të gjendej një rrugë tjetër për të vërtetuar autenticitetin e tyre. Nëse do të ekzistonte ndonjë dyshim për autenticitetin e tyre, ashtu siç është vepruar dhe për akte të tjera të dorëzuara nga subjekti, mund të kërkohej zyrtarisht verifikimi i vërtetësisë së tyre, nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve për marrjen e provës, përcaktuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016.

23.10. Gjatë seancës gjyqësore publike të datës 15.01.2024, në Kolegj, vëzhguesi ndërkombëtar iu drejtua subjektit të rivlerësimit, duke i bërë me dije paraprakisht se referuar legjislacionit italian të gjitha bankat italiane kanë detyrimin të mbajnë në arkivë dokumentacionin për të paktën 10 vjet dhe në momentin e kërkesës nga Komisioni kishin kaluar vetëm 9 (nëntë) vjet, kështu që sipas vëzhguesit ndërkombëtar ose nuk është paraqitur kërkesa e duhur e saktë nga subjekti i rivlerësimit apo vajza, përndryshe çfarë do ta pengonte vajzën për të ndihmuar subjektin lidhur me këtë çështje. Qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit ishte se ai nuk është shtetas italian dhe se vajza ka komunikuar verbalisht me punonjësit e bankës, të cilët janë shprehur se nuk mund ta ndihmojnë, pasi dokumentacioni aktualisht aplikohet në rrugë elektronike. Subjekti i rivlerësimit shprehet se është korrekt për atë që deklaroi se nuk ka dërguar ndonjëherë kërkesë dhe nuk ka pasur mundësinë të komunikojë me bankat italiane për të marrë një dokument. Megjithatë, ai sqaron se ka komunikuar me Ambasadën Italiane në Shqipëri, si dhe me “Intesa Sanpaolo Bank” ShA.

24. Lidhur me mosdorëzimin e të dhënave të llogarive bankare nga bankat e shtetit italian të vajzës së subjektit, për periudhën e kryerjes së studimeve të saj gjashtëmujore (tetor 2013 - prill 2014) në këtë shtet, ndonëse nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk u provua në mënyrë shteruese pamundësia objektive e dorëzimit të tyre, nga Komisionerja Publike, por edhe aktet e administruara në fashikull, nuk evidentuan asnjë *indicie* që mund të krijonte dyshime për kreditime apo debitime në këtë llogari bankare përtej atyre që deklaroi subjekti i rivlerësimit se janë shpenzuar në këtë periudhë. Në konsideratë edhe të faktit se vlera e shpenzuar prej subjektit të rivlerësimit për përballimin e shpenzimeve të vajzës për shkollimin rezultoi e mbuluar krejtësisht me burime të ligjshme dhe në kushtet e mungesës së ndonjë pretendimi të ndryshëm nga Komisionerja Publike lidhur me të, trupi gjykues gjen pa relevancë këtë fakt për kualifikimin e tij në ndonjë prej situatave të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, në kuadër të këtij procesi.
25. Trupi gjykues vlerësoi si të paargumentuar dhe pa referim të mirëpërcaktuar kërkimin e Komisioneres Publike për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga ankimi objekt shqyrtimi, por edhe nga aktet e administruara në këtë proces, nuk u evidentuan fakte, ngjarje apo të dhëna që mund të meritonin një analizë dhe vlerësim në kuadër të vlerësimit tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të pabazuar ankimin e Komisioneres Publike edhe për këtë pikë.
26. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Ylli Bashaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, krahas nivelit të besueshëm në dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, gjendet i drejtë, i mbështetur në fakte e në ligj dhe, për pasojë, ky vendim, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të tij, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 02.02.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 5, datë 02.02.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 671, datë 14.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj, për konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Parashtroj në vijim arsyet ligjore mbi të cilat bazohet bindshmëria për këtë mendim pakice.

2.1. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam çmuar jobindëse deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe aq më tepër shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me çmimin e likuiduar për apartamentin me sipërfaqe 93,03 m² të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, pasi do të ishte alogjike që subjekti i rivlerësimit të konfirmonte një çmim të cilin nuk do të mund ta mbulonte me të ardhura nga burime të ligjshme. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të vlerësohen të besueshme kur bien ndesh me dokumentacionin ligjor të kohës, si kontrata e shitjes nr. {***} rep./kol., që përcakton të shlyer vlerën 28.000 USD në datën 27.12.2000, dhe kredinë bankare në shumën 8.000 USD, të financuar nga Banka Italo-Shqiptare ShA sipas kontratës së financimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2001, të transferuar më datë 13.02.2001 në llogarinë bankare të shoqërisë së ndërtimit, me përshkrimin: “{***} ShPK për pagesën e kështit të fundit, për blerjen e apartamentit”.

2.2. Mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar në aktin “Gjetje dhe mendim” nr. {***} prot., datë 08.01.2024, ku shprehet se: *[...] duket qartë se B. S. ishte i përfshirë në procedimin penal nr. {***}, datë 15.10.2015, të pushuar nga subjekti i rivlerësimit; B. S. ka lëshuar vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.11.2022, të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila, në këndvështrimin e Vëzhguesit Ndërkombëtar, nuk mund të konsiderohet si provë e besueshme për të përcaktuar çmimin e apartamentit të blerë në vitin 2000 nga subjekti i rivlerësimit, edhe në zbatim të jurisprudencës përkatëse të KPA-së – e vlerësoj të drejtë.*

2.3. Çmtoj të pakontestueshëm faktin që subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se më datë 17.10.2015 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, me afat 30 ditë për shtetasin B. S., në cilësinë e prokurorit të çështjes, më datë 16.10.2015 kur ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***} për veprat penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 283/1 e 278/2 të Kodit Penal, nuk ka regjistruar emrin e shtetasit B. S. në regjistrin e personit që i atribuohet vepra penale, edhe pse vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” kishte të bënte vetëm me të, por është njaftuar vetëm me regjistrimin e emrit të shtetasit R. R.. Gjithashtu është fakt që subjekti i rivlerësimit në përfundim të veprimeve hetimore, më datë 11.01.2016 ka disponuar me vendimin “Për pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim B. S.”. Në këto kushte, vlerësoj të pashmangshme njohjen mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit B. S., me pasojë logjike, kompromentimin në mënyrë të padiskutueshme të besueshmërisë në vërtetimin nr.

{***} prot., datë 03.11.2022, ku krahas të dhënave dërguar Komisionit me shkresën me nr. {***} prot., datë 09.12.2022, z. S. ka përcaktuar modalitetet e pagesës pikërisht sipas deklarimeve/pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se blerësi Ylli Bashaj ka paguar në favor të shoqërisë vlerën totale 28.000 USD, nga të cilat 20.000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë “{***}” ShPK, dhe pjesa tjetër prej 8.000 USD është paguar me bankë.

2.4. Për sa arsyetuar më sipër, ashtu sikurse Komisionerja Publike, vlerësoj se shuma e paguar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 93,09 m², është 36.000 USD dhe jo 28.000 USD, sikurse është konsideruar nga shumica.

3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, pretendimet e Komisioneres Publike në ankim për rivlerësimin e zërave të analizës financiare lidhur me vlerën reale të blerjes së pasurisë 93,03 m², të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, dhe burimet e ligjshme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, kryesisht huat nga personat e tjerë të lidhur duhet të ishin vlerësuar drejt nga ana e Kolegjit, duke mos i përfshirë ato si burim i ligjshëm për këto arsye:

3.1. Mospërputhjet mes deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* kundrejt deklaratës fillestare e vitit 2003 dhe përgjigjeve të pyetësorit standard lidhur me vlerën totale të huas së marrë – në deklaratën fillestare të pasurisë, 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] 13.000 USD kursime, 2.000 USD K. B. - vëllai, 2.000 USD H. B. - djali i xhaxhait, 1.500 USD S. V. - Tiranë, 1.500 USD E. H. - Vlorë, 10.000 USD Banka Italo-Shqiptare, bashkë me interes me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.02.2001”, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*: “[...] 10.000 dollarë kursime nga të ardhurat, 10.000 dollarë marrë kredi në formën e borxhit, nga të afërmit dhe miqtë dhe 10.000 dollarë marrë kredi nga banka Italo-Shqiptare sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 01.02.2001”.

3.2. Mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, i ecurisë së marrëdhënies së huave dhe shlyerjeve të tyre si pretenduar në vitet 2004 – 2007.

3.3. Në kushtet e mospërputhjes së vlerës totale të huave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të vitit 2003, në vlerën 7.000 USD, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, në vlerën 10.000 USD, mungesa e provueshmërisë lidhur me shlyerjen e tyre, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin dhe shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj huadhënësve, detyrim ligjor i parashikuar në nenin 4, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ashtu edhe vlerat jodomethënëse të këtyre huave (1.500 USD apo 2.000 USD) në raport me mundësitë financiare të tre huadhënësve (K. B., S. V. dhe E. H.) duken si përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të plotësuar burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, por që në fakt nuk krijojnë bindjen se kanë ekzistuar.

Për sa arsyetuar më sipër, duke konsideruar çmimin e apartamentit në vlerën 36.000 USD, si dhe duke mos përfshirë si burim të ligjshëm huat e deklaruara, por të paprovuara në shumën 7.000 USD, rezultatet e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit do të tregonin një mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 2.060.675 lekë, konvertuar në 14.447 USD, sipas parashikimit të nenit 35, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Nëse shpenzimet jetike do të konsiderohen në masën 66% të të ardhurave nga pagat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për periudhën janar 1992 - dhjetor 1999, mungesa e

burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për periudhën 1992 – 27.12.2000, do të rezultojë në vlerën (-) 3.126.004 lekë apo (-) 16.995 USD.

4. Në përfundim, mbështetur në kundërshtimet e mia për konkluzionet e arritura nga shumica e trupit gjykues lidhur me vlerën e paguar të pasurisë apartament, me sipërfaqe 93,03 m², si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit Ylli Bashaj nuk arrin nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e këtij kriteri dhe, në vlerësimin tim, pamjaftueshmëria e burimeve financiare e sipërcituar kërkon zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe shkarkimin e tij nga detyra.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi